



RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**
për vitin 2019



RAPORT VJETOR

MBI VEPRIMTARINË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

për vitin 2019



PËRMBAJTJA

HYRJE	7
KAPITULLI I DEPUTETËT	9
KAPITULLI II VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË KUVENDIT	11
KAPITULLI III VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE	13
KAPITULLI IV KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA PARLAMENTARE	17
KAPITULLI V ZGJEDHJE, EMËRIME DHE SHKARKIME TË ORGANEVE KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA ME LIGJ	21
KAPITULLI VI NDRYSHIMET NË RREGULLOREN E KUVENDIT	23
KAPITULLI VII VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE	24
KAPITULLI VIII VEPRIMTARIA E NËNKOMISIONEVE PARLAMENTARE	26
KAPITULLI IX KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE	28



KAPITULLI X	
TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË PARLAMENTARE	29
KAPITULLI XI	
DIPLOMACIA PARLAMENTARE	36
KAPITULLI XII	
ROLI I KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN	42
KAPITULLI XIII	
BASHKËPUNIMI I KUVENDIT ME SHOQËRINË CIVILE	47
KAPITULLI XIV	
REFORMA NË SISTEMIN E DREJTËSISË	52
KAPITULLI XV	
ORGANIZIMET VULLNETARE	54
KAPITULLI XVI	
PROJEKTE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË	58
KAPITULLI XVII	
ADMINISTRIMI	61
KAPITULLI XVIII	
OBJEKTIVAT E SHËRBIMEVE TË KUVENDIT PËR VITIN 2020	71



Hyrje

Gjatë vitit 2019 Kuvendi i Shqipërisë është angazhuar për përsosjen e funksionimit të tij demokratik nëpërmjet promovimit dhe konsolidimit të debatit parlamentar, transparencës parlamentare dhe ndërmarrjes së reformave të rëndësishme në kuadër të procesit të integritetit evropian për përmirësimin e vazhdueshëm të funksionit kushtetues të ligjvënies dhe kontrollit parlamentar.

Kuvendi ka përmbushur objektivin parësor institucional për vitin 2019: përfaqësimin e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Në ushtrimin e funksionit të ligjbërjes dhe kontrollit parlamentar është synuar realizimi i një procesi gjithëpërfshirës shqyrtimi dhe diskutimi të projektligjeve, nisma të Këshillit të Ministrave ose të deputetit, zgjerimi dhe rritja e cilësisë së pjesëmarrjes së publikut, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, angazhimi i shoqërisë civile dhe mbështetja e veprimtarive për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së, forcimi i kontrollit parlamentar për zbatimin e ligjeve të miratuara dhe adresimin e çështjeve me interes publik.

Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit dhe bashkëpunimi i tij me institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, si objektiv tjetër institucional, ka synuar garantimin e pavarësisë, eficiencës dhe përgjegjshmërisë së tyre si dhe rritjen e rolit të tyre në mbrojtjen e interesit publik dhe të të drejtave të qytetarëve. Nëpërmjet mekanizmit ndërinstitucional bashkëpunimi dhe komunikimi mes Kuvendit, qeverisë dhe institucioneve të pavarura është bërë më dinamik, më transparent dhe më produktiv.

Kuvendi finalizoi nismën për interpretimin e seancave plenare në gjuhën e shenjave për njerëzit që nuk dëgjojnë, duke u ofruar akses për herë të parë në jetën politike të vendit këtij grupi jashtë vëmendjes së deritanishme. Nëpërmjet kësaj Kuvendi realizoi një angazhim më kuptimplotë në komunitet.

Kuvendi rriti dhe intensifikoi marrëdhëniet me vendet e BE-së, të rajonit dhe vendet me interesa strategjike për Shqipërinë, duke zhvilluar më tej dimensionin parlamentar në marrëdhëniet ndërkombëtare.





Kapitulli 1

DEPUTETËT

Mandatet

Viti 2019 shënoi për herë të parë rastin e dorëheqjeve kolektive nga mandati i deputetit. 41 deputetë të Partisë Demokratike dhe 17 deputetë të Lëvizjes Socialiste për Integrim (parti opozitare) paraqitën më 21.02.2019 dorëheqjen nga mandati i deputetit. Ndërkohë 5 deputetë të Partisë Socialiste (parti qeverisëse) lanë mandatin e deputetit për arsye të kandidimit në zgjedhjet vendore.

Në vijim të vakancave të krijuara si pasojë e dorëheqjeve nga mandati i deputetit, mandati i deputetit të Kuvendit u mor nga 23 deputetë nga lista e Partisë Demokratike, 17 deputetë nga lista e Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe 5 deputetë nga lista e Partisë Socialiste.

Pas verifikimit që iu bë mandateve të fituara dhe krahasimit me legjislacionin e zbatueshëm, rezultoi se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vendimmarrjen e tij kishte respektuar kërkesat e parashikuara në nenet 69, 70 dhe 71 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë të ndryshuar. Për dhënien e mandatit të deputetit KQZ-ja kishte respektuar nenin 164, pika 2 dhe pika 4 të ligjit nr. 10.019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, sipas së cilit: *“Mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë”* dhe *“në rastet kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë”*. Për deputetët nuk rezultoi asnjë paligjshmëri në zgjedhje. Deputetët bënë betimin në seancat plenare, që përbën kusht për fillimin e ushtrimit të mandatit të deputetit.

Lëvizjet në grupe parlamentare

Gjatë vitit 2019 Kuvendi fillimisht vijoi me të njëjtin formatim grupesh parlamentare të krijuara në fillim të legjislaturës. Grupet parlamentare vijuan veprimtarinë e tyre me emërtimet dhe përbërjet e mëposhtme:

Nr.	Grupi parlamentar	Numri i deputetëve	Largime nga grupi	Anëtarësime të reja
1.	Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste	74	1	1
2.	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike	33	-	-
3.	Grupi Parlamentar i Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”	19	1	-
4.	Grupi Parlamentar i Partisë Republikane	7	-	-



Pas dorëheqjeve të disa deputetëve të opozitës nga mandati Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste vijoi veprimtarinë e tij, ndërsa deputetët e rinj të opozitës pas plotësimit të deklaratave përkatëse u organizuan në grupet e mëposhtme parlamentare të krijuara sipas orientimit politik:

Nr.	Grupet parlamentare opozitare	Numri i deputetëve	Largime nga grupi	Anëtarësime të reja
1.	Grupi Demokrat	9	-	-
2.	Grupi i Pavarur	9	1	-
3.	Grupi i Partive të Djathta	7	-	-

29 deputetë nuk iu bashkuan grupeve parlamentare të krijuara.

Grupi Parlamentar i Partive të Djathta, për arsye të rënies së numrit minimal të deputetëve, pushoi së ekzistuari në të njëjtin vit.

Riformatimi i organeve parlamentare

Hyrja e deputetëve të rinj opozitarë në Kuvend u shoqërua me ndryshime në përbërjen e organeve të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ushtroi kompetencat e tij dhe ripërcaktoi listat e anëtarëve e të kryesive të delegacioneve të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare dhe grupeve të miqësisë, si dhe riformatimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe të Këshillit për Legjislacionin. Kuvendi vendosi riformatimin e komisioneve të përhershme dhe të strukturave të tjera parlamentare.



Kapitulli 2

VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË KUVENDIT

Veprimtaria e organeve drejtuese të Kuvendit

Zoti Gramoz Ruçi, i zgjedhur në fillim të legjislaturës me vendimin nr. 83, datë 9.09.2017, vazhdoi ushtrimin e funksionit të Kryetarit të Kuvendi edhe gjatë vitit 2019. Po ashtu edhe zëvendëskryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, e ushtroi këtë funksion edhe gjatë vitit 2019. Zëvendëskryetari Edi Paloka dha dorëheqjen nga mandati i deputetit më 21.02.2019. Deputeti Myslim Murriçi u zgjodh zëvendëskryetar i Kuvendit më 8.05.2019.

Gjatë vitit 2019 organet drejtuese kanë zhvilluar mbledhje për trajtimin e çështjeve në kompetencë të tyre sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit.

Konferenca e Kryetarëve ka zhvilluar 17 mbledhje për miratimin e programit të punës, kalendarit trejavor, kalendarit të raportimeve të institucioneve kushtetuese dhe atyre të ngritura me ligj, kalendarit të shqyrtimit të projektbuxhetit dhe paketës fiskale, kërkesa për ndryshim të rendit të ditës, kërkesa nga grupet parlamentare për zhvillimin e punimeve në seancë plenare, kërkesa për mocion me debat, kërkesa për ngritje komisionesh hetimore etj. Konferenca ka miratuar me mirëkuptim 6 programe pune dhe 10 kalendarë trejavorë, ndërsa 1 program pune dhe 2 kalendarë trejavorë janë miratuar në seancë plenare me shumicë votash për shkak të mungesës së mirëkuptimit në Konferencë. Konferenca ka marrë 16 vendime.

Byroja e Kuvendit ka zhvilluar 5 mbledhje për çështje administrative dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit si dhe për masa disiplinore ndaj deputetëve që kanë shkelur rëndë Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes gjatë punimeve parlamentare në seancë plenare. Byroja e Kuvendit ka marrë 13 vendime për çështjet e mëposhtme:

- Në cilësinë e autoritetit përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes ka marrë vendime për deputetët që kanë cenuar rëndë rendin dhe sigurinë gjatë zhvillimit të punimeve parlamentare në seancë plenare.

- Në ushtrim të kompetencës për miratimin e raporteve vjetore ka miratuar “Raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit për vitin 2018” dhe “Raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për vitin 2018”.

- Në ushtrim të kompetencës në lidhje me buxhetin e Kuvendit ka miratuar detajimin e buxhetit të Kuvendit për vitin 2019, planin e aktiviteteve dhe të shpenzimeve për kremtimin e 100-vjetorit të parlamentarizmit, raportin e monitorimit të buxhetit për vitin 2018, projektbuxhetin afatmesëm 2020–2020 (faza e parë) për Kuvendin, raportet e monitorimit të buxhetit të Kuvendit për 8-mujorin janar–gusht 2019, si dhe ka marrë vendime të tjera për mbarëvajtjen e punës.

- Në ushtrim të kompetencës për aktivizimin e ekspertëve të jashtëm ka miratuar kërkesën për aktivizimin e ekspertëve të jashtëm pranë Komisionit të Posaçëm për Realizimin e Reformës Zgjedhore.



Sekretariatet

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën ka zhvilluar dy mbledhje për çështjet e mëposhtme:

- shqyrtimi i kërkesës së kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim për çështje procedurale;
- shqyrtimi i kërkesës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për konstatim të shkeljes së etikës në punimet e Kuvendit në seancë plenare.

Sekretariati për Buxhetin, Sekretariati për Statusin e Deputetit, Sekretariati për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare, Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit nuk kanë zhvilluar asnjë mbledhje.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ka zhvilluar 12 mbledhje për verifikimin e mandatit të deputetëve të zgjedhur gjatë legjislaturës si pasojë e krijimit të vakancave në Kuvend.

Këshilli për Legjislacionin ka zhvilluar tri mbledhje për çështjet e mëposhtme:

- diskutimi i efekteve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe nevoja e ndërmarrjes së nismës ligjvënëse në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” pas shfuqizimit nga gjykata Kushtetuese të disa neneve në këto ligje;
- njohja me dy nismat ligjvënëse në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe propozimi për depozitim në Kuvend të këtyre nismave;
- shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Kuvendit mbi kushtetutshmërinë e vijimit të procedurës që do të zbatojë Kuvendi për votimin e vendeve të lira në Gjykatën Kushtetuese të shpallura nga Kuvendi në datat 12.02.2018 dhe 4.03.2019.

Krijimi i strukturave të reja parlamentare

Kuvendi ka ngritur strukturat parlamentare të përkohshme të mëposhtme:


1. Komisionin hetimor për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me dokumentin “*Certifikatë e Sigurimit të Personelit*” dhe për të hetuar nëse z. Cakaj ka pasur qasje në informacione të klasifikuara pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument në cilësinë e tij si zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore.
2. Komisionin hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Me vendimin nr. 140/2019 objekti i komisionit hetimor është shtuar si vijon: “*si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe të procedurës së ndjekur nga Presidenti i Republikës në emërimin e gjyqtarëve kushtetues*”.
3. Sekretariatin për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit me kompetencën për të ndjekur dhe mbikëqyrur punën e shërbimeve të Kuvendit të ngarkuara me garantimin e transparencës së veprimtarisë së Kuvendit si dhe punën për përdorimin e teknologjive të përparuara të informacionit (*e-parlament*) dhe modernizimin e funksioneve të shërbimeve që ofron administrata e Kuvendit.



Kapitulli 3

VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE

Veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit, bazuar në objektivat institucionale, përparësitë e përcaktuara në planin e veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raporteve të progresit të Komisionit Europian.




Gjatë periudhës janar–dhjetor 2019 u zhvilluan 37 seanca plenare, me një shtrirje kohore prej 188 orësh.

Kuvendi ushtroi funksionet e tij në 2 sesione të zakonshme dhe 1 sesion të jashtëzakonshme, konkretisht: sesioni i dytë: 21 janar–18 korrik 2019; sesioni i tretë: 2 shtator–18 dhjetor 2019; sesioni i jashtëzakonshëm: 16 janar 2019. Sesioni i jashtëzakonshëm u mbledh me kërkesë të Kryeministrit për disa ndryshime në përbërjen e

Këshillit të Ministrave. Kuvendi miratoi 278 akte, nga të cilat 97 ligje, 152 vendime, 28 rezoluta dhe 1 deklaratë.

U zhvilluan 1016 diskutime në 136 orë debat parlamentar. Nga këto shumica parlamentare zhvilloi 606 diskutime në 87 orë, ndërsa pakica parlamentare zhvilloi 410 diskutime në 49 orë.

Gjatë vitit 2019 u depozituan 124 nisma ligjvënëse, nga të cilat 105 nga Këshilli i Ministrave, 19 nga deputetë, prej të cilave 13 nga deputetë të mazhorancës dhe 6 nga deputetë të opozitës. Pra, 85% e nismave ligjvënëse kanë qenë nisma të Këshillit të Ministrave, 15 % nisma të deputetëve.





Kuvendi miratoi 97 ligje, nga të cilat 84 ligje janë nisma të Këshillit të Ministrave dhe 13 ligje janë nisma të deputetëve.

Me konsensus u miratuan 53 ligje:

- 59 ligje u miratuan me shumicë të thjeshtë;
- 33 ligje u miratuan me shumicë absolute;
- 5 ligje u miratuan me shumicë të cilësuar.

Ndërkohë 3 projektligje u tërhoqën nga nismëtari, ndërkohë që projektligje/nisma të tjera vijnë në procedurë parlamentare, duke u mbartur në programe dhe kalendarë pune gjatë vitit 2020.

Ligje të shqyrtuara dhe miratuara me procedurë të përshpejtuar

Kuvendi ka miratur me procedurë të përshpejtuar projektligjet e mëposhtme të paraqitura nga Këshilli i Ministrave:

- “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”;

- “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”;

- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 «Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme»”;

- “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, nën tokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 «Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit»”, i ndryshuar”;

- “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në detin Mesdhe”;

- “Për një ndryshim në ligjin nr 55/2015 «Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë»”, i ndryshuar”.

Projektakte të shqyrtuara në seancë plenare bazuar në kërkesën për ndryshimin e rendit të ditës

Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi me kërkesën për ndryshimin e rendit të ditës aktet e mëposhtme:

- Akt normativ nr. 8, datë 16.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”.

- Akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Ligje të kthyera për rishqyrtim

Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend 15 ligje. Kuvendi vendosi rrëzimin e dekretit për 14 ligje dhe ka pranuar në 1 rast dekretin duke riformuluar nenet përkatëse. Ligjet e kthyera për rishqyrtim dhe vendimet e Kuvendit janë:

- Vendim nr. 29/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11054, datë 14.01.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 110/2018 ‘Për noterinë’»”.

- Vendim nr. 56/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11 175, datë 19.04.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 20/2019 ‘Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 ‘Për vlerësimin kalimtar dhe



periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’»”.

- Vendim nr. 74/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11 195, datë 31.05.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 26/2019 ‘Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat’»”.

- Vendim nr. 93/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11255, datë 8.08.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 52/2019 ‘Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë ‘ANK, sh.p.k’, si koncesionari, dhe shoqërisë ‘Bardh Konstruksion, sh.p.k’, si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot–Balldren’»”.

- Vendim nr. 92/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11254, datë 8.08.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 51/2019 ‘Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe ‘Gjikuria, sh.p.k’, si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Ruga Orikum–Llogara, sh.p.k’ për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës porti i jahteve–bajpasi Orikum–Dukat (ura e Shën Elizës)’»”.

- Vendim nr. 91/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11 251, datë 5.08.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 50/2019 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 ‘Për koncesionet dhe partneritetin publik–privat, i ndryshuar’»”.

- Vendim nr. 90/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11235, datë 24.07.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 42/2019 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin e territorit, i ndryshuar’»”.

- Vendim nr. 89/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11227, datë 15.07.2019, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 38/2019 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’»”.

- Vendim nr. 88/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11226, datë 15.07.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 37/2019 ‘Për disa shtesa në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.07.2008 të Këshillit të Ministrave ‘Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve’, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.07.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 3/2015’175”.

- Vendim nr. 87/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11225, datë 15.07.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 36/2019 ‘Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, ‘Për rezervat materiale të shtetit’»”.

- Vendim nr. 107/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11248, datë 5.08.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 44/2019 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar’»”.

- Vendim nr. 108/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11256, datë 8.08.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 53/2019 ‘Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë’»”.

- Vendim nr. 144/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11343, datë 6.11.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 71/2019 ‘Për Korporatën e Investimeve Shqiptare’»”.

- Vendim nr. 145/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11367, datë 25.11.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 75/2019 ‘Për rininë’»”.

- Vendim nr. 30/2019 “Për miratimin e dekretit nr. 11055, datë 15.01.2019, të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 111/2018 ‘Për kadastrën’»”.

Nisma ligjvënëse të tërhequra nga nismëtari

Nga nismat ligjvënëse të depozituara në Kuvend u tërhoqën nga nismëtari nismat e mëposhtme:

- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, «Për ndihmën



dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar»”;

- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96, datë 6.10.2016, «Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë»”;

- projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë»”.

Nisma ligjvënëse të rrëzuara në parim

Me vendimin nr. 132/2019 Kuvendi vendosi mosmiratimin e projektligjit “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor”.

Çështjet e futura automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim

Në programin e punës së Kuvendit u përfshinë automatikisht për shqyrtim 57 çështje, të cilat kryesisht ishin projektligje financiare, dekrete për rishqyrtim ligji dhe nisma deputetësh.



Kapitulli 4

KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Veprimtaria e Kuvendit është shtrirë edhe në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare, si funksion kushtetues i rëndësishëm i tij. Kuvendi ushtroi kontroll mbi ekzekutivin dhe mbikëqyri edhe veprimtarinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Kuvendi ushtroi kontroll mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumenteve ligjore bashkëkohore, si: interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore për çështje të zbatimit të ligjeve, komisioneve hetimore, seancës së pyetjeve, mocioneve për debat etj.

Kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare e ushtruar në seancë plenare paraqitet më poshtë.

Kërkesat për interpelancë

Kuvendi ushtroi kontrollin mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumentit më të rëndësishëm të kontrollit parlamentar: interpelancës. Kërkesat për interpelancë kanë qenë si më poshtë:

- Kërkesë për interpelancë urgjente me ministren e Financave dhe të Ekonomisë, znj. Anila Denaj, kërkuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Socialiste për Integrim me objekt: *dhënien e shpjegimeve pse dega e thesarit Skrapar ka bllokuar gjithë veprimtarinë financiare (furnizimin me ushqim për konviktet, çerdhet, qendrat e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe pagat e punonjësve).*

- Kërkesë për interpelancë urgjente me ministrin e Brendshëm, z. Sandër Lleshaj, kërkuar nga një grup deputetësh lidhur me grabitjen e një shume të konsiderueshme valute të huaj në territorin e brendshëm të aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” në datën 9 prill 2019, planin e masave të marra nga institucionet ligjzbatuese për mbrojtjen e sigurisë kombëtare si dhe mbi zbatimin e legjislacionit në fuqi për ruajtjen e rendit publik në ambientet e këtij objekti strategjik të rëndësisë së veçantë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Kërkesë për interpelancë me ministren e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj, kërkuar nga deputeti Lefter Maliqi lidhur me politikat e Ministrisë së Drejtësisë për sistemin penitenciar (burgjeve), për konfliktin e interesit, korrupsionin, prokurimet, testimet si dhe problemet e drejtimit dhe menaxhimit të gjithë sistemit penitenciar.

- Kërkesë për interpelancë me ministren e Infrastrukturës dhe Energjetikës, kërkuar nga deputeti Artur Roshi për politikat mbi strategjinë e koncesioneve të rrugëve dhe hidrocentraleve në vendin tonë.

- Kërkesë për interpelancë urgjente me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Besa Shahini, lidhur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 1.05.2019 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve me institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2019–2020”, arsyet e rritjes së mesatares dysheme për ndjekjen e shkollës së lartë me afekte prapavepruese përtej parashikimeve ligjore dhe pa konsultim paraprak me grupet e interesit.



- Interpelancë me ministren e Financave, znj. Anila Denaj, kërkuar nga zoti Myslim Murrizi *lidhur me politikën fiskale të ndjekur kohët e fundit në lidhje me aksionin kundër informalitetit si dhe goditjet selektive ndaj bizneseve, nga njëra anë, dhe favorizimi për mospagesë gjobe prej miliona eurosh, nga ana tjetër, për subjekte të veçanta.*

- Interpelancë urgjente kërkuar nga një grup deputetësh me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme lidhur me rastin e Alvin Berishës në kampin e Sirisë.

Kërkesa për informacion

Kërkesa për informacion vazhdoi të ishte instrumenti i kontrollit më i përdorur. Deputetët paraqitën 95 kërkesa drejtuar titullarëve të institucioneve shtetërore dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave. 35 kërkesa u paraqitën nga deputetët e mazhorancës, ndërsa 60 nga deputetët e opozitës.

Raportimet vjetore të institucioneve të pavarura

Në kuadër të ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare ndaj organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, bazuar në kuadrin ligjor organik për raportimin vjetor, 23 institucione raportuan në Kuvend. Konkretisht:


Nr.	Institucionet kushtetuese dhe të krijuara me ligj që kanë raportuar në Kuvend
1.	Banka e Shqipërisë
2.	Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në Komision)
3.	Këshilli i Lartë Gjyqësor (në Komision)
4.	Avokati i Popullit
5.	Prokurori i Përgjithshëm
6.	Këshilli i Ministrave për ecurinë e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian
7.	Enti Rregullator i Energjisë
8.	Autoriteti i Konkurrencës
9.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
10.	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri
11.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
12.	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
13.	Enti Rregullator i Ujit
14.	Autoriteti i Medieve Audiovizive
15.	Radiotelevizioni Shqiptar
16.	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
17.	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
18.	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
19.	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
20.	Komisioni i Prokurimit Publik
21.	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
22.	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
23.	Instituti i Statistikave



Kuvendi vlerësoi veprimtarinë e 21 institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2018, si dhe me rezolutë u caktoi objektiva konkretë për vitin 2019. Raportimet në seancë plenare për 16 institucione janë shoqëruar me debat.

Kuvendi miratoi 7 rezoluta me objekt:

- ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare;
- shmangien e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese, detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit;
- mbështetjen e procesit të fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian;
- mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”;
- njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë;
- për vlerësimin e punës së Grupit të Deputetëve “Miq të Fëmijëve” për vitin 2018 dhe për planin e veprimit për vitin 2019;
- për progresin e Shqipërisë në procesin e integritimit në Bashkimin Europian gjatë vitit 2018.



Mocione për debat

Kuvendi zhvilloi dy mocione me debat për çështjet e mëposhtme:

- mocion me debat shoqëruar me projektrezolutën “Për shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10928, datë 5.11.2018 «Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”;
- mocion me debat shoqëruar me projektrezolutën “Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës

Kushtetuese, detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit”.

Komisionet hetimore

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8891, datë 2.05.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komiseve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit”, me propozimin e një grupi prej më shumë se një e katërta e anëtarëve të pakicës parlamentare Kuvendi me vendimin nr. 24 ngriti komisionin hetimor për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me dokumentin “*Certifikatë e Sigurimit të Personelit*” dhe për të hetuar nëse z. Cakaj ka pasur qasje në informacione të klasifikuara pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument në cilësinë e tij si zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore. Komisioni nuk arriti të paraqesë në seancë plenare raportin përfundimtar të hetimeve.

Me vendimet nr. 84/2019 dhe nr. 140/2019 të Kuvendit u ngrit komisioni hetimor për kontrollin e




ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe të procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Ky komision vazhdon veprimtarinë e tij hetimore.



Kapitulli 5

ZGJEDHJE, EMËRIME DHE SHKARKIME TË ORGANEVE KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA ME LIGJ

Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i titullarëve dhe anëtarëve të institucioneve monokratike dhe kolegjiale, kushtetuese dhe të krijuara me ligj është një detyrim që rrjedh nga Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligjet organike. Komisionet e përhershme parlamentare, në përmbushje të kërkesave procedurale të parashikuara nga neni 111 i Rregullores së Kuvendit si dhe ligjeve organike, gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore kanë shqyrtuar përmbushjen e kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidaturave të paraqitura, si dhe kanë vlerësuar meritën dhe profesionalizmin mbi bazën e respektimit të parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes. Në rastet e shkarkimeve është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.



Kuvendi vendosi për çdo kandidaturë të propozuar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj sa më poshtë:

- 9 vendime për miratim dekreti për emërim ministri;
- 7 vendime për miratim dekreti për lirim ministri;
- 21 vendime për zgjedhje në institucione kushtetuese/të krijuara me ligj;
- 2 vendime për moszgjedhje në institucionet kushtetuese;
- 4 vendime për shkarkim nga detyra në institucionet e krijuara me ligj.

Kuvendi ushtroi funksionin zgjedhës në rastet kur zgjodhi në organet kushtetuese:

- Në mbështetje të nenit 125, pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, Kuvendi me vendimet nr. 133/2019 dhe 134/2019 zgjodhi znj. Elsa Toska dhe znj. Fiona Papajorgji anëtare të Gjykatës Kushtetuese.

- Në mbështetje të nenit 148/a të Kushtetutës dhe të nenit 35 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi me vendimin nr. 138/2019 zgjodhi z. Olsian Çela Prokuror të Përgjithshëm.



Kuvendi ushtroi funksionin zgjedhës në rastet kur zgjodhi në organet e krijuara me ligj:

- anëtari dhe kryetari i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERRE);
- komisionerët e Avokatit të Popullit;
- anëtarët dhe kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- anëtarët e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF);
- anëtarët e Këshillit të Statistikave;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.



Kapitulli 6

NDRYSHIMET NË RREGULLOREN E KUVENDIT

Në muajin korrik të vitit 2019 Kuvendi miratoi propozimet për ndryshime në Rregulloren e tij. Ndryshimet kushtetuese për kufizimin e imunitetit dhe reformën në drejtësi, raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, rekomandimet e organizmave të tjerë ndërkombëtarë adresuar Kuvendit si dhe rekomandimet nga shoqëria civile dhe deputetë të pavarur diktuan domosdoshmërinë e përmirësimit të Rregullores.

Ndryshimet e miratuara përmirësuan ndjeshëm dispozitat e Rregullores së Kuvendit, duke e sjellë atë në përputhje me standardet më të larta të demokracisë parlamentare dhe modelet më të përparuara ndërkombëtare në bashkëpunim me të gjitha forcat politike që përfaqësohen në Kuvend. Në mënyrë të posaçme në Rregullore u reflektuan ndryshimet kushtetuese të vitit 2012 për kufizimin e imunitetit të deputetit si dhe jurisprudenca kushtetuese për përcaktimin e kuorumit të votimit dhe shumicës në vendimmarrjen e Kuvendit.

Rekomandimet e ndërkombëtarëve, përmendim këtu raportin e dytë të raundit IV të GRECO-s¹ dhe rekomandimet e ekspertëve të BE-së për zbatimin e projektit të binjakëzimit “*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*” në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë², zunë një vend të rëndësishëm me qëllim:

- përmirësimin e procedurave në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, duke siguruar një kontroll më efektiv të përputhshmërisë së projektligjeve dhe një cilësi më të mirë të legjislacionit shqiptar;
- forcimin e mëtejshëm të rolit monitorues të Kuvendit;
- realizimin e pavarësisë buxhetore të Kuvendit, transparencën financiare të burimeve të financimit të Kuvendit dhe përdorimit të tyre nga deputetët;
- harmonizimin e dispozitave të Rregullores me Kodin e Sjelljes dhe krijimin e mekanizmit të ankimit ndaj masave disiplinore që mund t’i jepen deputetit;
- bërjen efektive të mekanizmit të monitorimit të Kuvendit në përmbushjen e rekomandimeve të institucioneve të pavarura;
- rritjen e transparencës së veprimtarisë kontrolluese të Kuvendit, veçanërisht në publikimin e pyetjeve të deputetëve dhe përgjigjeve të marra;
- rritjen e perceptimit publik për Kuvendin si një institucion plotësisht i hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit;
- monitorimin e ecurisë së procesit të integritetit europian si dhe të raportimit në Kuvend për këtë proces si nga Këshilli i Ministrave, ashtu dhe nga institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj.

¹ GRECO, strukturë e Këshillit të Europës (Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit).

² Periudha e zbatimit të këtij projekti ka qenë 12 muaj (5 maj 2017–5 maj 2018), gjatë së cilës u zhvilluan 30 aktivitete sipas 4 komponenteve të projektit.



Kapitulli 7


VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE

Komisionet e përhershme parlamentare kanë pasur një axhendë pune intensive si në aspektin e shqyrtimit të projektligjeve, ashtu dhe në atë të forcimit të kontrollit parlamentar, duke shqyrtuar dhe miratuar akte të rëndësishme, që lidhen me reformat politike, ekonomike dhe sociale në vend.

Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar gjithsej 292 akte ligjore, nga të cilat 80 janë nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, 12 akte normative, 84 nisma ligjore të reja dhe 116 projekt marrëveshje.

Komisionet e përhershme kanë shqyrtuar 28 projektrezoluta, nga të cilat 20 për veprimtarinë vjetore të institucioneve të pavarura dhe 8 për çështje të tjera, 19 dekrete të Presidentit të Republikës si dhe 37 projektvendime, nga të cilat 5 për miratim strukture dhe organike, 25 për zgjedhjen, emërimin apo dhënien e pëlqimit të institucioneve të pavarura dhe 7 për çështje të tjera.

E gjithë veprimtaria e punës së komisioneve të përhershme parlamentare është realizuar në 435 mbledhje me një kohëzgjatje prej 502 orësh.



Nga 435 mbledhjet e organizuara gjatë periudhës janar–dhjetor 2019, 153 mbledhje janë organizuar në formën e seancave dëgjimore, gjatë së cilave kanë marrë pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore dhe publike, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit si dhe grupime të tjera të interesuara. Nga këto seanca 81 janë organizuar në kuadër të procesit legjislativ, 52 seanca në kuadër të kontrollit parlamentar dhe 19 seanca në kuadër të procesit zgjedhës.

Në gjithë veprimtarinë e zhvilluar nga komisionet deputetët u kanë drejtuar përfaqësuesve të

Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera që ishin të pranishëm në mbledhje 3046 pyetje, nga të cilat 1921 pyetje janë për procesin legjislativ, 1049 janë për kontrollin parlamentar dhe 76 pyetje për procesin zgjedhës.



Ligjbërja

Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar 285 projektligje, nga të cilat 80 ishin nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, përfshirë këtu edhe 1 akt normativ për ndryshimin e ligjit të buxhetit për vitin 2019, 84 nisma të reja ligjore, 116 projekt marrëveshje.

Nga 138 nismat ligjore 110 ishin propozime të Këshillit të Ministrave, 27 propozime të një deputeti ose grupi deputetësh dhe 1 ishte propozim i 20 mijë zgjedhësve.

Nga 138 projektligjet e shqyrtuara në komisione 114 u miratuan nga Kuvendi, 6 u rrëzuan, 4 u tërhoqën nga nismëtari dhe 14 janë në procedurë shqyrtimi.

Për të gjitha nismat ligjore të shqyrtuara në komisionet e përhershme parlamentare janë propozuar dhe miratuar 784 amendamente, nga të cilat 661 kanë qenë propozime të deputetëve anëtarë të komisioneve dhe 123 kanë qenë propozime të grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile.

Gjithashtu për vitin 2019 komisionet e përhershme parlamentare shqyrtuan 19 dekrete të Presidentit të Republikës, 17 prej tyre për rishqyrtim ligji, nga të cilat kanë miratuar 3 dhe kanë rrëzuar 14 të tjera, 2 dekrete janë për emërimin, zgjedhjen në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj.

Kontroll/mbikëqyrje parlamentare


Për periudhën janar–dhjetor 2019 komisionet e përhershme parlamentare kanë organizuar 169 seanca dëgjimore, përfshirë edhe seancat dëgjimore për shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Gjatë seancave dëgjimore deputetët e pranishëm në mbledhje u kanë drejtuar 1049 pyetje përfaqësuesve të institucioneve të thirrura për dëgjuesë.

Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar 44 raporte, nga të cilat 31 për veprimtarinë vjetore të organeve Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, ndërsa 13 raporte trajtonin çështje të veçanta të veprimtarisë së komisioneve. Në përfundim të shqyrtimit të raporteve komisionet kanë paraqitur për miratim në seancë plenare 28 projektrezoluta, nga të cilat 20 për veprimtarinë e organeve Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj dhe 8 për çështje të veçanta.

Në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, komisionet e përhershme parlamentare gjatë periudhës janar–dhjetor 2019 kanë miratuar 5 projektvendime për miratim strukture dhe organike.

Zgjedhje, emërimet dhe shkarkime

Për periudhën janar–dhjetor 2019 komisionet e përhershme parlamentare, në përputhje me dispozitat që parashikon Rregullorja për procesin e emërimit, zgjedhjes dhe shkarkimit të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj të veçantë, kanë zhvilluar 22 seanca dëgjimore me kandidatët e propozuar nga institucionet e përcaktuara në ligjet specifike. Në përfundim të këtyre seancave komisionet kanë miratuar një numër prej 23 projektvendimesh për zgjedhjen ose jo të kandidaturave të propozuara.





Kapitulli 8

VEPRIMTARIA E NËNKOMISIONEVE PARLAMENTARE

Nënkomisioni për Administratën Publike

Nënkomisioni për Administratën Publike ka zhvilluar tri mbledhje, me kohë zgjatje rreth 4 orë. Veprimtaria e Nënkomisionit është fokusuar në monitorimin nëpërmjet mekanizmave të kontrollit parlamentar dhe mbështetjen e të gjitha institucioneve ligjzbatuese dhe përgjegjëse për administratën publike në Shqipëri, në funksion të një qeverisjeje demokratike, transparente, efektive, për të ofruar shërbime publike dhe për të kultivuar konkurrencën dhe zhvillimin e vendit, në përmbushje edhe të prioritetëve të përcaktuara për integrimin në BE.

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje, me kohëzgjatje rreth 7 orë. Veprimtaria e Nënkomisionit është fokusuar në konsultimin publik të projektligjeve që prekin të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtat e grupeve të marginalizuara, si: gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës dhe të trafikimit, pakicat kombëtare, personat me orientim seksual të ndryshëm, si dhe në gjetjen e problematikave të evidentuara nga institucionet e pavarura dhe organizatat që monitorojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut.

Në adresë të Nënkomisionit janë ardhur raporte, rekomandime dhe kërkesa të institucioneve të pavarura që monitorojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nënkomisioni ka zhvilluar disa seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura dhe organizata që mbrojnë të drejtat e njeriut. Kontrolli parlamentar në mbrojtje të të drejtave të njeriut ka qenë në fokus të veprimtarisë së Nënkomisionit, i cili u ka kërkuar institucioneve të ndryshme informacion për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në kuadër të transparencës dhe forcimit të mekanizmave për të siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë, Nënkomisioni krijoi një praktikë të re në veprimtarinë parlamentare, duke ftuar institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile që të bëhen pjesë e procesit përzgjedhës.

Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore

Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore ka zhvilluar 2 mbledhje, me kohë zgjatje rreth një orë. Veprimtaria e tij është fokusuar në monitorimin dhe mbështetjen nëpërmjet mekanizmave të kontrollit parlamentar të të gjitha institucioneve ligjzbatuese dhe përgjegjëse për qeverisjen vendore në Shqipëri. Nënkomisioni i është drejtuar 61 njësite të qeverisjes vendore me një kërkesë për informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve.



Nënkomisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për Vetting-un në Polici

Nënkomisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për Vetting-un në Polici ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 320 minutash. E gjithë veprimtaria e Nënkomisionit për vitin 2018 ka qenë në funksion të ushtrimit të kontrollit parlamentar.

Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin

Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin ka zhvilluar një seancë dëgjimore informuese me ministrin e Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, lidhur me veprimtarinë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitin 2018.

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas ka zhvilluar tri seanca dëgjimore në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar. Dy prej tyre janë realizuar në bashkëpunim me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Aleancën e Grave Deputete. Nënkomisioni ka organizuar gjithashtu edhe aktivitete të ndryshme.



Kapitulli 9

KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE

Komisioni i Posaçëm për Realizimin e Reformës Zgjedhore ka zhvilluar gjithsej 11 mbledhje, të cilat janë drejtuar me konsensus nga dy bashkëkryetarët: zoti Damian Gjiknuri dhe zonja Rudina Hajdari. Në këto mbledhje Komisioni ka miratuar programin e punës së tij, grupin e ekspertëve të tij, kërkesën për mbështetje me ekspertizë nga OSBE-ja për sistemin zgjedhor. Komisioni ka miratuar ngritjen e katër grupeve pune me deputetë të shumicës dhe të pakicës për çështje të tilla si: financimi i partive politike, sistemi zgjedhor, ushtrimi i së drejtës për të votuar nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kuotat gjinore dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile.

Në bashkëpunim dhe me asistencën teknike të Prezencës së OSBE-së në Tiranë Komisioni ka zhvilluar tryeza me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët kanë prezantuar modelet më të mira ndërkombëtare për sistemet zgjedhore. Në këto tryeza kanë marrë pjesë në nivel teknikë edhe ekspertë të opozitës joparlamentare.

Komisioni ka zhvilluar tryeza edhe me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, të cilat në fokus të veprimtarisë së tyre kanë monitorimin e procesit zgjedhor në Shqipëri, me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse të ngarkuar me menaxhimin e proceseve zgjedhore, të cilët kanë dhënë opinionin e tyre për temat e diskutuara.

Disa nga organizatat e shoqërisë civile, deputetë dhe grupe deputetësh kanë depozituar në Komision opinione për dispozita të ndryshme të Kodit Zgjedhore si dhe propozime për ndryshimin e sistemit aktual zgjedhor, të cilat do të vlerësohen gjatë diskutimeve dhe miratimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor.

Komisioni ka dëgjuar argumentet e ekspertëve, opinionet e shoqërisë civile dhe të partive joparlamentare për shtesat dhe ndryshimet e propozuara në Kodin Zgjedhor dhe ka diskutuar nen për nen këto ndryshime.



Kapitulli 10

TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË PARLAMENTARE

Kuvendi i Shqipërisë ka fuqizuar më tej transparencën parlamentare përmes krijimit të kushteve të duhura për marrëdhëniet dhe ndërveprimin gjithnjë e më të ngushtë me qytetarët, ndërtimin e marrëdhënieve funksionale me publikun si dhe intensifikimin e punës në drejtim të rritjes së perceptimit publik për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin. Janë për t'u përmendur aktivitetet e organizuara, duke paraqitur në një mënyrë më lehtë të aksesueshme pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të studentëve në veprimtaritë e Kuvendit.

Në sektorin tonë për shkak të interesit publik, rregullimi i etikës është një çështje e vlerësuar deri në detaje, duke përfshirë respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe korrektësinë në sjellje.

Në kuadër të krenimit të 100-vjetorit të parlamentit dhe urdhrit nr. 374, datë 12.06.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për realizimin e aktiviteteve për krenimin e 100-vjetorit të parlamentit”, grupi i punës realizoi me sukses e cilësi brenda afateve për procedurat e përcaktuara në këtë urdhër. Një ndër aktivitetet me rëndësi të veçantë ishte konkursi ndërkombëtar në gjimnazet e Shqipërisë, ku disa nga fjalimet më të mira në parlament u dramatizuan nga nxënësit e gjimnazeve dhe kishte 9 + 1 fitues. Shkolla fituese u shpall nga zëvendëskryetari i Kuvendit në një nga “Ditët e Dyerive të Hapura” pranë Kryesisë së Kuvendit.

Fituesit iu dha një dhuratë simbolike, ku në thelb kishte këtë ditë të shënuar: “100 vjet parlamentarizëm shqiptar”. Realizimi i dhuratave u bë në bashkëpunim me argjendarinë “Pirro”, ndërsa certifikatat për secilin konkurrent u realizuan bashkë me Shërbimin e Botimeve Parlamentare.

Në funksion të rritjes së transparencës ndaj publikut është bërë përditësimi i programit të transparencës së veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparente veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë përmes paraqitjes së detajuar të tij dhe lehtësisht të kuptueshme në faqen zyrtare www.parlament.al.

Akresi i publikut në Kuvend

Komunikimi dhe informimi i vazhdueshëm publik, duke shtuar transparencën dhe aksesin në punimet e organeve parlamentare, është në përmbushje të misionit të Kuvendit të Shqipërisë për të qenë i përgjegjshëm, i aksesueshëm dhe efikas.

Edhe gjatë vitit 2019 Kuvendi ka organizuar aktivitete në bashkëpunim me qytetarët dhe shoqërinë civile, ka krijuar kushte për pjesëmarrjen e publikut, të qytetarëve dhe të studentëve në aktivitetet dhe veprimtaritë e Kuvendit.

Në muajin janar 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë) 60 vizitorë, konkretisht shkolla “Albanët” dhe “Sami Frashëri”.

Në muajin shkurt 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë) 296 persona nga Akademia Europiane “Bavaria” e Gjermanisë, studentë të ekselencës në Tiranë, studentë të Fakultetit të Drejtësisë, nxënës të gjimnazit “Partizani”, të shkollës së mesme



“Misto Mame” dhe të shkollës 9-vjeçare “Albanët”, gazetarë etj.

Në muajin mars 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë) 22 persona.

Për shkak të protestave dhe ngjarjeve të ndryshme pranë mjediseve të Kryesisë së Kuvendit dhe sallës së seancave plenare nuk u miratua kërkesa e grupeve të ndryshme për të ndjekur seancën plenare. Pritja e publikut është bërë vetëm pranë Kryesisë së Kuvendit.

Në muajin prill 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë) 261 persona, konkretisht: nxënës të shkollës 9-vjeçare “Albanët”, 6 klasa nga shkolla profesionale “Hoteleri-turizëm”, studentë të Fakultetit të Shkencave Bashkëkohore nga Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë (Republika e Maqedonisë së Veriut).

Në muajin maj 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë) 34 persona, konkretisht studentë të Universitetit “New York” dhe individë të ndryshëm.

Në muajt qershor–gusht 2019 nuk ka pasur kërkesa për aktivitete parlamentare si rezultat i mbylljes së sezonit shkollor.

Në muajin shtator 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë e Kuvendit) 25 persona, kryesisht qytetarë dhe një delegacion gjerman.

Në muajin tetor 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë e Kuvendit) 202 persona, të cilët ishin praktikantë nga organizata NDI, nxënës dhe qytetarë. Në datën 30 tetor 2019 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi aktivitetin “Parlamenti i parë i nxënësve” në sallën e seancave plenare.

Në muajin nëntor 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë e Kuvendit) 10 persona: studentë dhe praktikantë nga organizata NDI.

Në muajin dhjetor 2019 kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë (sallën e seancave plenare dhe Kryesinë e Kuvendit) 179 persona: qytetarë, praktikantë nga organizata NDI dhe një grup studentësh nga Fakulteti Ekonomik, të cilët zhvilluan një takim në mjediset e Kryesisë së Kuvendit me deputetin Ervin Bushati.

Në përmbushje të transparencës, edhe gjatë kësaj legjislature përgjegjshmërinë, si një instrument i rëndësishëm në marrëdhëniet me publikun, e kemi treguar duke respektuar parimet e ligjshmërisë, duke qenë të hapur, transparentë, të paanshëm dhe duke i konsideruar të gjithë të barabartë para ligjit. Të gjitha ankesat, kërkesat, peticionet janë trajtuar dhe u është dhënë zgjidhja e duhur, duke i këshilluar për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të tyre, duke siguruar kështu vlera si eficienta, efektiviteti dhe besueshmëria. Transparenca në kontekstin shoqëror përgjithësisht nënkupton të qenët i hapur, komunikimin dhe dhënien e përgjegjësisë.

Gjatë vitit 2019 janë trajtuar 354 letra dhe 2 peticione. Çështjet kryesore të adresuara nga qytetarët janë:

- kërkesa për shtesë pensioni të posaçëm;
- problemet mbi pronësinë;
- çështje të punësimit;
- kërkesa për informacion;
- peticione për problematika të ndryshme;
- kërkesa për amnisti;
- çështje me gjyqësorin dhe drejtësinë;
- çështje për kthimin dhe kompensimin e pronave;
- kërkesa për shërbime sociale;
- mosmarrëveshje familjare;
- kërkesa për fonde dhe mundësi bashkëpunimi për projekte të ndryshme.



Kuvendi i Shqipërisë ka ndërmarrë hapa konkretë për realizimin e bashkëpunimit me qytetarët dhe shoqërinë civile. Në përmbushje të këtij misioni është fuqizuar më tej transparenca parlamentare përmes krijimit dhe publikimit të materialeve informuese dhe edukuese, si dhe janë në proces realizimi i këndeve historike në funksion të publikut si dhe intensifikimi i punës në drejtim të rritjes së perceptimit publik për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin.

Në kuadër të projektit me parlamentin zviceran mbi shkëmbimin e përvojave në marrëdhëniet me publikun dhe edukimit qytetar janë organizuar takime, *workshop*-e me parlamentin zviceran (SPS), prezantime, diskutime, ture parlamentare. Të gjitha konkluzionet dhe idetë janë diskutuar dhe i janë paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm nëpërmjet raportimeve sipas programeve të punës. Ndër programet kryesore përmendim 3 më kryesorët:

1. The Game “My Point Of View”
2. The Tours of Parliament
3. Virtual Tour

Referuar Ditëve të Hapura mbi festat e 28 dhe 29 Nëntorit 2019, u bashkëpunua edhe me organizatën e NDI-së mbi realizimin e materialeve promociionale (artikuj dhe fletëpalosje) për informim jo vetëm për studentët, por edhe për qytetarët. Ndër to përmendim:

- lojën “Quiz” mbi aktivitetet dhe historinë e parlamentit;
- fletëpalosje me informacion bazë të procesit ligjvënës, historikun, komisionet;
- çanta me logon e Kuvendit;
- stilolapsa;
- bookmarks.

Gjithashtu janë realizuar takime të shpeshta me organizatën e NDI, administratën dhe ekspertë (inxhinier) të fushës mbi krijimin e Qendrës së Vizitorëve pranë sallës së seancave plenare, ku do të realizohen aktivitete të ndryshme me nxënësit e shkollave, me studentë, deputetët dhe publikun mbi parlamentin dhe aktivitetin e tij.

Shënim. Aktiviteti “Dyert e Hapura” në datat 28 dhe 29 nëntor 2019 nuk u zhvillua, pasi u shpall gjendja e jashtëzakonshme për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019.

Programi i transparencës, e drejta e publikut për informim

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” u përgatit programi i transparencës për Kuvendin e Shqipërisë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së Kuvendit në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Kuvendi ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale. Kuvendi ka përditësuar herë pas here programin e transparencës në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014.

Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Kuvendit nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare *www.parlament.al* si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Çdo person i interesuar ka të drejtën e informimit, si një element i rëndësishëm i transparencës. Këtë të drejtë e kanë ushtruar me anë të një kërkesë për t’iu vënë në dijeni ose në dispozicion dokumenti lidhur me procedurat e caktuara. Në mbështetje të këtij parimi të rëndësishëm, janë kthyer përgjigjet me shkrim, brenda afateve dhe limiteve të përcaktuara në këtë ligj, kërkesave të marra si në rrugë



zyrtare dhe me postë elektronike.

Kuvendi dhe media



Bashkëpunimi me medien për garantimin e transparencës parlamentare në bazë të parimeve të objektivitetit dhe paanshmërisë ka qenë një nga tiparet më të rëndësishme për Kuvendin e Shqipërisë. Gjatë vitit 2019 sektori i medias ka ndjekur dhe pasqyruar mbledhjet e komisioneve parlamentare në faqen zyrtare të Kuvendit në internet, ka realizuar 271 njoftime, si dhe ka monitoruar shtypin e shkruar ditor në dy rrugë (monitorim përmes agjencisë “Delta Publicity” dhe monitorim i pavarur i brendshëm i institucionit nga zyra e shtypit).

Kërkimi Parlamentar dhe Biblioteka

Kërkimi Parlamentar

Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet Shërbimit të Kërkimit Parlamentar ka ofruar 142 informacione kërkimore (88 me kërkesë dhe 54 me vetiniciativë), me qëllim mbështetjen e veprimtarisë parlamentare në realizimin e detyrave gjatë procesit legjislativ dhe kushtetues.


Informacionet me kërkesë përmbajnë 35 produkte kërkimore (informacione të shkurtra, krahasuese, analiza) në përgjigje të kërkesave të deputetëve (21 nga mazhoranca dhe 14 nga opozita), 53 produkte informuese në mbështetje të veprimtarisë së stafit dhe 23 produkte informuese nga bashkëpunimi me Qendrën Europiane të Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar (ECPRD).



Gjatë vitit 2019 ndryshoi cilësisht hartimi i produkteve kërkimore për standardizimin e llojeve të produkteve, formatit dhe strukturave të përmbajtjes (nga programi i Mentorship, me mbështetjen e NDI-së).

Korrespondenca me ECPRD-në

Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet Shërbimit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës është pjesë e rrjetit ndërkombëtar për shkëmbim informacioni parlamentar ECPRD (Qendra Europiane e Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar), me të cilin kanë bashkëpunuar rregullisht gjatë vitit 2019.



Numri i kërkesave të ardhura gjatë vitit 2019 si dhe numri i produkteve të punuara referuar përgjigjeve të kthyer rezultojnë si më poshtë:

Gjatë vitit 2019 u paraqitën 73 kërkesa dhe u përgatitën 54 përgjigje, u hartuan 23 produkte kërkimore. 11 kërkesa i janë drejtuar rrjetit të mësipërm nga Kuvendi (55% nga deputetë). Respektimi i afateve si dhe informacioni i shkëmbyer ka shërbyer në mbështetjen me informacion gjatë shqyrtimit të projektligjeve si dhe në funksion të punës së administratës të Kuvendit.

Bashkëpunimi rajonal

Bashkëpunimi rajonal ka zgjeruar bazën e të dhënave me informacion, duke shtuar burimet kërkimore të besueshme e të përditësuara. Nga ky bashkëpunim u hartua produkti kërkimor referuar “Regjistrimit të banesave dhe popullsisë, rasti i Shqipërisë”, si dhe u përgatit një produkt rajonal nën drejtimin e Institutit Parlamentar të Maqedonisë së Veriut, i cili përfshin gjithë përvojat rajonale.

Botimet e dokumentacionit parlamentar dhe revista

Kuvendi i Shqipërisë gjatë vitit 2019 ka realizuar 19 punime, 10 botime parlamentare, si “Reforma në sistemin e drejtësisë”, vëllimi I, II, pjesa 1, pjesa 2, Kodit të Sjelljes së Deputetit, në bashkëpunim me Sekretariatit e Botimeve.

Revista “Kuvendi” vijon botimin dhe publikimin edhe gjatë vitit 2019. Kjo revistë përmban artikuj shkencorë jo vetëm nga deputetë dhe administrata e Kuvendit, por dhe nga punonjës të institucioneve të arsimit të lartë në vend.

Në kuadër të transparencës Kuvendi i Shqipërisë publikon gjithë procesverbalet e seancave plenare, të mbledhjeve të komisioneve si dhe të organeve të tjera të Kuvendit.

Për vitin 2019 janë zbardhur dhe redaktuar 37 seanca plenare, me një kohë zgjatje 11.088 minuta, që janë pasqyruar në 1971 faqe.

Gjithashtu janë zbardhur dhe redaktuar 443 mbledhje komisionesh, me kohë zgjatje 32.391 minuta, që janë pasqyruar në rreth 11.512 faqe.



Administrimi i faqes zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë

Tabela e vizitave sipas Google Analytics për periudhën 1 janar 2019–1 janar 2020

Page	Pageviews	Unique Pageviews	Avg. Time on Page	Entrances	Bounce Rate	% Exit	Page Value
	901,795 % of Total: 100.00% (901,795)	605,277 % of Total: 100.00% (605,277)	00:01:20 Avg for View: 00:01:20 (0.00%)	242,417 % of Total: 100.00% (242,417)	43.51% Avg for View: 43.51% (0.00%)	26.88% Avg for View: 26.88% (0.00%)	\$0.00 % of Total: 0.00% (\$0.00)
1. /	207,639 (23.03%)	136,525 (22.56%)	00:01:40	127,030 (52.40%)	28.58%	29.24%	\$0.00 (0.00%)
2. /Projektligje/IndexList	90,775 (10.07%)	26,251 (4.34%)	00:00:46	5,378 (2.22%)	30.27%	11.12%	\$0.00 (0.00%)
3. /LibrariaAkteve	30,757 (3.41%)	7,149 (1.18%)	00:00:49	2,090 (0.86%)	38.13%	11.19%	\$0.00 (0.00%)
4. /VendePune	24,383 (2.70%)	11,866 (1.96%)	00:00:41	5,112 (2.11%)	30.58%	20.46%	\$0.00 (0.00%)
5. /Kuvendi/Kushtetuta	17,544 (1.95%)	12,572 (2.08%)	00:01:42	11,161 (4.60%)	68.55%	62.60%	\$0.00 (0.00%)
6. /Projektligje/IndexList	17,528 (1.94%)	12,161 (2.01%)	00:01:02	6,746 (2.78%)	24.98%	22.89%	\$0.00 (0.00%)
7. /Kuvendi/Historiku	16,174 (1.79%)	11,902 (1.97%)	00:01:27	5,802 (2.39%)	64.62%	39.62%	\$0.00 (0.00%)
8. /Projekte	14,913 (1.65%)	4,976 (0.82%)	00:00:48	758 (0.31%)	36.81%	10.46%	\$0.00 (0.00%)
9. /Procesverbale	13,848 (1.54%)	3,034 (0.50%)	00:00:48	374 (0.15%)	20.05%	6.46%	\$0.00 (0.00%)
10. /GrupParlamentar	11,840 (1.31%)	6,259 (1.03%)	00:00:32	782 (0.32%)	30.95%	8.20%	\$0.00 (0.00%)

	Shikueshmëria e faqeve (unike) (1 janar 2019–1 janar 2020)	Shikueshmëria e faqeve (unike) (1 janar 2019–1 janar 2020)
Faqja zyrtare e internetit të Kuvendit (<i>www.parlament.al</i>)	901.795	605.277

Interaktivitet më të madh ka pasur në faqet e mëposhtme:

- Kryefaqja
- Projektligje
- Libraria e akteve
- Vende pune
- Kushtetuta
- Historiku
- Projekte
- Procesverbalet dhe grupet parlamentare

Platforma ndërinstitucionale on-line

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” ka ngritur Mekanizmin Ndërinstitucional, i cili synon rritjen dhe përmirësimin e kontrollit parlamentar.

Gjatë vitit 2019 u punua për ngritjen e platformës on-line institucionale, qëllimi i së cilës është rritja e efikasitetit të zbatimit të Mekanizmit Ndërinstitucional për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ana e ministrive dhe institucioneve qeveritare, koordinimi më i mirë dhe më efikas i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, pasja e një sistemi transparent dhe kontrolli parlamentar më efikas mbi ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve



Platforma ndërinstitucionale mund të aksesohet nëpërmjet linkut [http://134.0.63.165:5000 / publik](http://134.0.63.165:5000/).

Aplikacioni “Kuvendi i Shqipërisë”

Risi për vitin 2019 në Kuvend në kuadër të përmirësimit të faqes zyrtare të Kuvendit ishte instalimi dhe publikimi i aplikacionit “Kuvendi i Shqipërisë”. Ky aplikacion është një vlerë e shtuar për Kuvendin dhe qytetarët për rritjen e transparencës, nxitjen dhe forcimin e komunikimit me qytetarët dhe grupet e interesit, i cili krijon mundësi të konsultohen dhe njihen zhvillimet, procesverbalet, projektligjet, projektvendimet, libraria e akteve etj., si dhe ndjekje në *livestream* të mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe seancave plenare.

Sistemi audio-video për sallën e mbledhjeve të grupeve parlamentare

Viti 2019 përmirësoi edhe transparencën e veprimtarisë së organeve të Kuvendit e në veçanti veprimtarinë e grupeve parlamentare. U instalua sistemi audio-video me 41 poste (mikrofona) dhe 2 kabina përkthimi. Ky sistem u integrua me sistemin audio-video të instaluar në komisionet parlamentare të Kuvendit. Me instalimin e këtij sistemi për sallën e mbledhjeve të grupeve parlamentare u plotësuan me sistem audio-video të gjitha sallat ku zhvillohen mbledhje në Kuvendin e Shqipërisë.

Përgatitjet për kremtimin e 100-vjetorit të parlamentarizmit shqiptar

Gjatë vitit 2019 u zhvilluan të gjitha veprimtaritë përgatitore për kremtimin e 100-vjetorit të parlamentarizmit shqiptar dhe u krijua një faqe interneti me adresë <http://100vjetparlament.al> për këtë veprimtari. Në këtë faqe interneti publikohen materiale informuese dhe edukuese mbi veprimtarinë parlamentare dhe historinë si dhe zhvillimet e parlamentarizmit në Shqipëri.



Kapitulli 11

DIPLOMACIA PARLAMENTARE

Viti 2019 ishte një vit i rëndësishëm për diplomacinë parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë të cilit u zhvilluan mjaft veprimtari parlamentare ndërkombëtare.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë ndërkombëtare të Kuvendit kanë qenë:

- intensifikimi i veprimtarisë parlamentare për avancimin e axhendës europiane të Shqipërisë dhe kryesisht veprimtaria lobuese për të siguruar mbështetje për hapjen e negociatave;
- intensifikimi i kontakteve me parlamente të vendeve të ndryshme, me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare;
- forcimi i bashkëpunimit rajonal, me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta, zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve.

Aktivitetet kryesore ndërkombëtar gjatë periudhës janar–dhjetor 2019 janë:

- 2 vizita të kryeparlamentarëve të vendeve të huaja në Shqipëri;
- 4 vizita të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë jashtë vendit me ftesë të homologëve e tij;
- 50 takime të Kryetarit të Kuvendit me personalitete nga vende të ndryshme, si presidentë, kryeministra, ministra të Punëve të Jashtme, ambasadorë etj.;
- 18 takime të nënkryetarëve të Kuvendit me personalitete të ndryshme;
- 82 takime të kryetarëve të komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë, kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetarëve të grupeve të miqësisë dhe deputetëve me personalitete të ndryshme ndërkombëtare;
- 4 pjesëmarrje të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në konferenca dhe aktivitete të ndryshme;
- 6 pjesëmarrje të nënkryetares së Kuvendit në forume, aktivitete shumëpalëshe dhe delegacione zyrtare.
- 1 aktivitet shumëpalësh: takimi vjetor i përfaqësuesve të Komisioneve të Mbrojtjes dhe Sigurisë nga parlamentet e Europës Juglindore;
- 113 pjesëmarrje të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare si dhe pjesëmarrje në aktivitete dhe seminare të deputetëve dhe të punonjësve të administratës së Kuvendit të Shqipërisë.

Roli i Kryetarit të Kuvendit në diplomacinë parlamentare

Gjatë vitit 2019 Kryetari i Kuvendit ka realizuar një axhendë të ngjeshur në kuadër të veprimtarisë parlamentare, me fokus të veçantë veprimtarinë lobuese për çeljen e negociatave të Shqipërisë me BE-në. Në funksion të arritjes së këtij objekti janë realizuar 4 vizita të Kryetarit të Kuvendit në vende mike, 4 pjesëmarrje në konferenca shumëpalëshe, si dhe janë realizuar 2 vizita të kryetarëve të parlamenteve të vendeve mike në Tiranë.

Në datat 14–16 prill 2019 një delegacion i kryesuar nga Kryetari i Kuvendit zhvilloi një vizitë pune



në Romë (Itali) me ftesë të Presidentes së Senatit Casellati dhe Presidentit të Dhomës së Deputetëve Fico. Në fokus të kësaj vizite ishte koordinimi i përpjekjeve për marrjen e një vendimi pozitiv për çeljen e negociatave të BE-së me Shqipërinë në qershor 2019. Gjatë vizitës zyrtare në Itali Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, u prit në takime të veçanta nga Presidentja e Senatit Maria Elisabetta Alberti Casellati dhe Presidenti i Dhomës së Deputetëve Roberto Fico. Delegacioni i Kuvendit zhvilloi një takim me parlamentarë të miqësisë me Shqipërinë, me të cilët biseduan për forcimin e bashkëpunimit dhe të shkëmbimeve parlamentare midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Senatit e Dhomës së Deputetëve të Italisë. Gjithashtu Kryetari i Kuvendit dhe delegacioni parlamentar shqiptar zhvilluan një seancë dëgjimore me deputetë dhe senatorë, anëtarë të komisioneve të jashtme të Senatit dhe të Dhomës së Deputetëve.

Më 6–7 maj 2019, me ftesë të Kryetarit të Parlamentit të Austrisë, z. Wolfgang Sobotka, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Vjenë. Gjatë bisedimeve zyrtare të zhvilluara dy kryeparlamentarët shprehën kënaqësinë e veçantë për nivelin e marrëdhënieve midis të dy vendeve. Z. Wolfgang Sobotka rikonfirmoi mbështetjen e Austrisë për hapjen e negociatave për anëtarësimin e shqipërisë si dhe angazhimin e tij për të punuar me vendet skeptike për një rezultat pozitiv gjatë mbledhjes së Këshillit të Europës në qershor të këtij viti. Z. Gramoz Ruçi shpjegoi me hollësi sukseset dhe sfidat e reformave në Shqipëri e në mënyrë të veçantë të kryereformës, siç e quajti ai transformimin rrënjësor të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Gjatë vizitës në Vjenë z. Gramoz Ruçi zhvilloi bisedime me Kryetarin e Këshillit Federal të Austrisë, z. Ingo Appé dhe ministrin e Drejtësisë, z. Josef Moser. Në takimin me Nënkomisionin për Politikën e Jashtme dhe çështjet e BE-së gjithë spektri politik austriak u shpreh dakord për mbështetjen e vendit tonë për hapjen e negociatave për anëtarësim.

Më 21–22 maj 2019 një delegacion i kryesuar nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Mbretërinë e Holandës. Delegacioni u prit në takim nga Kryetarja e Dhomës së Ulët të parlamentit, znj. Khadija Arib, dhe zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të Komisionit për Çështjet e Jashtme të Dhomës së Ulët të parlamentit dhe u prit nga Presidentja e Senatit të Holandës, znj. Ankie Brokers-Knol. Gjithashtu delegacioni zhvilloi takime në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës dhe me aktorë të ndryshëm politikëbërës në Holandë. Gjatë takimeve u vlerësuan arritjet e qeverisë në reformën në drejtësi dhe në procesin e vetting-ut, për të cilat po kontribuojnë edhe ekspertët holandezë, në konsolidimin e shtetit ligjor, bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën ekonomike si dhe bashkëpunimin në luftën kundër emigracionit ilegal dhe krimit të organizuar.

Në datat 3–4 qershor Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, i ftuar nga Kryetari i parlamentit të Republikës Çeke, z. Radek Vondráček, zhvilloi një vizitë zyrtare në Pragë, e cila ishte stacioni i fundit i veprimtarisë lobuese të Kryetarit të Kuvendit për të siguruar mbështetje për hapjen e negociatave.

Në datat 28 tetor–2 nëntor 2019 Kryetari i Kuvendit zhvilloi një vizitë zyrtare në Tokio, ku zhvilloi takime me përfaqësues të lartë parlamentit dhe të qeverisë japoneze. Gjatë takimit me Kryetarin e parlamentit të Japonisë, z. Tadamori Ôshima, u konstatua se marrëdhëniet midis dy vendeve aktualisht janë shumë të mira. Bashkëpunimi parlamentar, si një dimension i rëndësishëm të marrëdhënieve dypalëshe, u konsiderua si një element i rëndësishëm që mund të kontribuojë në nxitjen e investimeve japoneze në Shqipëri, veçanërisht në bujqësi, në peshkim, në transportin hekurudhor dhe atë ajror, në parqet industriale, në sektorin e energjisë, të naftës, në miniera, në shëndetësi, në industrinë e fasonit etj. Delegacioni i Kuvendit u takua edhe me anëtarë të kabinetit qeveritar, me drejtuesit e grupit parlamentar të miqësisë me Shqipërinë dhe anëtarë të tjerë të Dhomës së Përfaqësuesve, me të cilët biseduan mbi fuqizimin e bashkëpunimit dypalësh, nxitjen e investimeve, ecurinë e projekteve japoneze në Shqipëri dhe intensifikimin e shkëmbimeve të gjithanshme midis të dy vendeve.

Në datat 13–14 shkurt 2019 Kryetari i parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi, zhvilloi një vizitë në Tiranë me rastin e ratifikimit të Protokollit për anëtarësimin e Republikës



së Maqedonisë së veriut në NATO.

Pjesëmarrje në aktivitetet shumëpalëshë

Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet delegacioneve të përhershme pranë organizatave ndërkombëtare ka bërë të mundur që të ruajë dhe të zhvillojë marrëdhënie efektive me këto organizata.

Në datat 6–10 prill 2019 u mbajt në Doha (Katar) sesioni i 140-të i Unionit Ndërparlamentar (IPU), i cili mblodhi së bashku anëtarë nga më shumë se 170 parlamente të botës nën moton “Për demokracinë, për këdo”. Delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë kryesohej nga Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i cili mori pjesë në debatin e përgjithshëm mbi temën “Parlamentet si platformë për të rritur edukimin për paqen, sigurinë dhe sundimin e ligjit”.

Gjatë pjesëmarrjes në Asamblenë e Unionit Ndërparlamentar në Doha delegacioni shqiptar zhvilloi takime me delegacione të parlamenteve të vendeve të ndryshme. Tema kryesore e bisedave ishte bashkëpunimi ndërparlamentar, ndërsa në takimet me deputetë të vendeve anëtare të BE-së, si Gjermania, Italia, Rumania, Greqia etj., u shkëmbyem mendime dhe u ndanë informacione mbi hapat e hedhur nga Shqipëria në procesin e integritimit Europian.

Gjatë qëndrimit në Doha z. Gramoz Ruçi dhe kryeparlamentarët pjesëmarrës zhvilluan një takim me sheikun Tamim Bin Hamad Al Thani, Emir i Shtetit të Katarit.

Më 8–9 prill 2019 Kryetari i Kuvendit mori pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të Bashkimit Europian, që u mbajt në Vjenë në kuadër të presidencës austriake të Këshillit të Bashkimit Europian. Gjatë ditëve të Konferencës Kryetari i Kuvendit zhvilloi takime dypalëshe me kryetarët e parlamenteve të disa vendeve anëtare të BE-së, si: Kryetarin e parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka; Kryetarin e Bundestagut të Gjermanisë, z. Wolfgang Schäuble; Kryetarin e parlamentit të Suedisë, z. Andreas Norlén; Kryetaren e Senatit të Holandës, Ankie Broekers-Knol; Kryetarin e parlamentit të Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi; Kryetarin e parlamentit të Greqisë, z. Nikos Voutsis; zëvendëskryetaren e parlamentit të Francës, znj. Carole Bureau-Bonnard; Kryetarin e Komitetit për Çështjet Europiane në Senatin e Francës, z. Jean Bizet etj.

Gjatë këtyre takimeve u prezantuan arritjet e Shqipërisë në përmbushjen e pesë prioritetëve kyç të reformave të integritimit të përcaktuara nga Këshilli i Europës dhe u kërkuar mbështetje për çeljen e negociatave në qershor 2019. Kryeparlamentarët e vendeve europiane shprehën vlerësime shumë pozitive për arritjet e Shqipërisë në përmbushjen e prioritetëve kyç të reformave të procesit të integritimit dhe ofruan asistencën teknike të parlamenteve të tyre për procesin e negociimit.

Konferenca e Kryetarëve të Parlamenteve të Vendeve Anëtare të BE-së në përfundim të takimit të Vjenës bëri thirrje për vijimin e procesit të zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor përmes një progresi të dukshëm dhe vijimit me hapat e tjerë të anëtarësimit për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit. Drejtuesit e 28 parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së vlerësuan rezultatet e arritura dhe nxitën vijimin e reformave në përmbushje të kriterit të anëtarësimit në BE.

Në datën 15 tetor 2019 Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, dhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla, zhvilluan një takim në Bruksel me Presidentin e Parlamentit Europian, z. David-Maria Sassoli. Kryetari i Kuvendit, pasi e falënderoi Presidentin Sassoli për mbështetjen e tij personale dhe të Parlamentit Europian për ndihmën në rrugëtimin europian të Shqipërisë dhe për çeljen e negociatave, e informoi atë për arritjet e Shqipërisë në përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian dhe të Këshillit të Europës për prioritetet kyçe. “Parlamenti Europian është i qartë në qëndrimet e tij, sepse jemi shumë të kënaqur nga përparimi i Shqipërisë. Unë do t’i drejtohem mbledhjes së Këshillit të Europës me prezantimin e qëndrimit të Parlamentit Europian pro çeljes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Destinacioni i Shqipërisë është i qartë dhe i shkruar: Bashkimi Europian”, – u shpreh Presidenti David-Maria Sassoli.

Gjatë vizitës në Bruksel Kryetari i Kuvendit dhe z. Taulant Balla zhvilluan takime edhe me kryetarin



e Komisionit të Jashtëm të Parlamentit Europian, z. David McAllister, me të cilin u bisedua mbi bashkëpunimin e mëtejshëm të Parlamentit Europian me Shqipërinë, duke u fokusuar në qëndrimet e përbashkëta në politikën e jashtme, bashkëpunimin rajonal e më gjerë.

Më 24–25 tetor 2019 në Strasburg u zhvillua konferenca e kryetarëve të vendeve anëtare të Këshillit të Europës. Në konferencë mori pjesë një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë i kryesuar nga Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i cili mbajti një fjalë në sesionin e parë të konferencës me temë “Europa jonë e përbashkët: 70 vjetët e ardhshme”.

Gjatë qëndrimit në Strasburg delegacioni i Kuvendit u takua me Sekretaren e Përgjithshme të Këshillit të Europës, znj. Maria Pejcinovic Buriç, dhe Presidenten e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, znj. Liliane Maury Pasquier. Delegacioni shqiptar zhvilloi takime edhe me Kryetarin e parlamentit të Sllovenisë, z. Dejan Židan; Kryetarin e parlamentit të Danimarkës, z. Henrik Dam Kristensen; Presidentin e Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio, dhe Presidentin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, z. George Tseterelli.

Veprimtaria parlamentare në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe

Aktivitet intensiv në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe të Kuvendit të Shqipërisë me parlamente të vendeve mike është zhvilluar edhe në nivel zëvendëskryetarësh të parlamenteve, të komisioneve parlamentare dhe të grupeve parlamentare të miqësisë.

Zëvendëskryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, përfaqësoi Kuvendin e Shqipërisë në disa aktivitete ndërkombëtare si më poshtë:

- në sesionin e dhjetë të Parlamentit të Grave për vendet e rajonit tonë në kuadër të rezolutës mbi të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor, organizuar në parlamentin malazes në datën 8 mars 2019;
- në Samitin për Partneritet të Hapur Qeveritar, mbajtur në Otava (Kanada) më 29–30 maj 2019;
- në Forumin e Nivelit të Lartë Politik të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm, mbajtur në Nju-Jork më 8–19 korrik 2019;
- në takimin e 4-t të Kryetarëve të Parlamenteve të Vendeve të Euroazisë me temë “Euroazia e madhe: dialogu, besimi, partneriteti”, zhvilluar në Nur-Sultani më 23–24 shtator 2019;
- në Konferencën Parlamentare Rajonale mbi forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut dhe legjisllacionit gjinor në Ballkanin Perëndimor, organizuar në Podgoricë më 7–8 tetor 2019;
- në takimin e 9-të të Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të Europës Juglindore, organizuar nën kujdesin e Kryetarit të parlamentit të Hungarisë, z. Lazlo Kover, më 4 nëntor 2019.

Vizita të zëvendëskryetarëve të parlamenteve të vendeve të tjera në Tiranë

Më 15–17 prill 2019 me ftesë të Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, zhvilloi vizitë në Tiranë një delegacion i Komisionit Kombëtar të Konferencës Politike Konsultative të Popullit Kinez, i kryesuar nga nënkryetari i Komisionit, z. Zhang Qingli.

Në datat 5–7 qershor 2019 zhvilloi vizitë zyrtare në Tiranë delegacioni i parlamentit të Polonisë, kryesuar nga zëvendëskryetari i parlamentit, z. Ryszard Terlecki.

Vizita në kuadër të delegacioneve nga komisionet parlamentare

Shkëmbimet e vizitave dypalëshe në kuadër të delegacioneve nga komisionet parlamentare kanë pasur në fokus intensifikimin e marrëdhënieve me vendet e rajonit si dhe vendet anëtare të BE-së.



Në këtë kuadër janë zhvilluar 11 vizita të delegacioneve nga komisionet parlamentare të parlamenteve mike dhe nga delegacione të huaja që kanë vizituar Shqipërinë si më poshtë:

- Në datat 1–3 prill 2019 në Gjenevë (Zvicër) anëtarë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, zhvilluan një vizitë studimore në Qendrën për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe në Qendrën e Politikave të Sigurisë (GCSP).

- Në datat 5–7 maj 2019 një delegacion i Komisionit për Politikën e Jashtme, i kryesuar nga znj. Mimi Kodheli, zhvilloi një vizitë zyrtare në Budapest.

- Në datat 13–14 maj 2019 një delegacion i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zhvilloi një vizitë pune në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

- Në datën 14 maj 2019 një delegacion i Komisionit të Integritetit Europian zhvilloi një vizitë zyrtare në Asamblenë Kombëtare të Francës (Paris).

- Në datën 29 maj 2019 në ambientet e Kuvendit të Kosovës u mbajt një tryezë e rrumbullakët mbi çështjet e vetting-ut. Në këtë aktivitet mori pjesë kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. z. Ulsi Manja.

- Në datat 16–18 shtator 2019 një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë, i kryesuar nga znj. Mimi Kodheli, kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bullgari me ftesë të znj. Dzhema Grozdanova, kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme në parlamentin bullgar.

- Në datat 7–8 tetor 2019 një delegacion i Komisionit për Integritetin Europian zhvilloi një vizitë pune në parlamentin e Mbretërisë së Danimarkës.

- Në datat 8–9 tetor 2019 në Londër (Britani e Madhe) u zhvillua Forumi Ndërkombëtar i Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Inteligjencës. Në këtë aktivitet mori pjesë një delegacion i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, i kryesuar nga znj. Ermonela Valikaj (Felaj), kryetare e Komisionit.

- Në datën 21 tetor 2019 një delegacion i Komisionit për Integritetin Europian në Kuvendin e Shqipërisë, i kryesuar nga znj. Senida Mesi, nënkryetare e Komisionit, zhvilloi një vizitë në Rumani me ftesë të z. Angel Tilvar, kryetar i Komisionit për Çështjet Europiane në Dhomën e Deputetëve të parlamentit të Rumanisë.

- Në datat 12–14 nëntor 2019 në Nairobi (Kenia) u zhvillua Samiti i Nairobiut për ICPD+25. Në këtë Samit mori pjesë znj. Eglantina Gjermani në cilësinë e kryetares së Nënkomisionit për Barazinë Gjinore në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Elona Hoxha dhe znj. Klodiana Spahiu.

- Në datat 18–20 nëntor 2019 një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë, i kryesuar nga znj. Mimi Kodheli, kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë, zhvilloi një vizitë pune në Shkup me ftesë të kryetarit të Komisionit për Politikën e Jashtme në Maqedoninë e Veriut, z. Miloshoski.

Delegacione të huaja që kanë vizituar Kuvendin e Shqipërisë

- Në datat 27–29 janar 2019, me ftesë të kryetares së Komisionit të Jashtëm, znj. Mimi Kodheli, zhvilloi vizitë në Tiranë një delegacion nga Komisioni i Jashtëm i parlamentit të Malit të Zi, i kryesuar nga z. Andrija Nikolić, kryetar i Komisionit.

- Në datat 20–22 shkurt 2019 zhvilloi vizitë në Kuvendin e Shqipërisë një delegacion i Komisionit për Çështjet Europiane të Dhomës së Deputetëve të parlamentit të Republikës Çeke, i kryesuar nga z. Ondřej Benešík.

- Në datat 27–28 shkurt 2019 një delegacion i Komisionit për Çështjet Europiane i Republikës së Sllovakisë, i kryesuar nga z. Ľuboš Blaha, kryetar i Komisionit, zhvilloi një vizitë në Tiranë.

- Në datat 11–13 qershor 2019 një delegacion i Komisionit të Jashtëm të parlamentit të Kroacisë, i kryesuar nga kryetari i Komisionit, z. Miro Kovač, zhvilloi një vizitë pune në Shqipëri.

- Në datat 3–8 nëntor 2019 zhvilloi vizitë në Tiranë një delegacion i Komisionit të Shëndetësisë



dhe Politikës Sociale të Senatit të Republikës Çeke, i kryesuar nga znj. Miluše Horská, kryetare e Komisionit, dhe zëvendëskryetare e Senatit.

Aktivitetet e grupeve parlamentare të miqësisë

Grupi i Miqësisë Shqipëri–Poloni

Në datat 18–19 mars 2019 një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Varshavë (Poloni) me ftesë të kryetarit të Grupit të Miqësisë Poloni–Shqipëri, z. Tomasz Glokovski, pranë parlamentit të Polonisë. Morën pjesë znj. Mimi Kodheli, kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme; znj. Evis Kushi, kryetare e Grupit Parlamentar të Miqësisë Shqipëri–Poloni; z. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Grupi i Miqësisë Shqipëri–Gjermani

Në datat 23–24 shtator 2019, në kuadër të diskutimit dhe vendimmarrjes për çeljen e negociatave me Shqipërinë për anëtarësim në Bashkimin Europian, z. Mark Hauptmann, deputet i Bundestagut gjerman, ftoi z. Taulant Balla, në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, për një vizitë pune në Bundestag. Në përbërje të delegacionit ishte edhe deputeti Ervin Bushati.

Grupi i Miqësisë Shqipëri–Izrael

Në datat 24–26 tetor 2019 në Pragë (Republika Çeke) u zhvillua takimi i dytë i Aleancës Europiane Parlamentare për Izraelin. Morën pjesë z. Bujar Çela, anëtar i Grupit të Miqësisë Shqipëri–Izrael, dhe znj. Milva Ekonomi, anëtare e Grupit të Miqësisë Shqipëri–Izrael.

Veprimtari të delegacioneve të përhershme parlamentare

Delegacionet parlamentare ruajnë dhe zhvillojnë kontaktet ndërkombëtare të Kuvendit me organizmat ndërkombëtarë respektive, duke kontribuar në promovimin e vlerave dhe parimeve të lirisë dhe demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut, të lirive themelore dhe të shtetit ligjor. Kontaktet ndërkombëtare të Kuvendit synojnë të zhvillojnë më tej dimensionin parlamentar të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në Kuvendin e Shqipërisë, në mbështetje të pikës 3 të nenit 7 të Rregullores së Kuvendit, janë ngritur delegacionet e përhershme parlamentare pranë organizatave ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2019 ka pasur një pjesëmarrje të vazhdueshme të delegacioneve në Asamblesë Parlamentare të NATO-s, të Këshillit të Europës, të OSBE-së, PABSEC-ut, SEECP-së, IPU-së, PE-së, në nismat rajonale CEI, PAM, si dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të këtyre organizatave.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 85 pjesëmarrje në kuadër të veprimtarisë shumëpalëshe të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2019 kanë qenë të ftuar të Kuvendit të Shqipërisë disa delegacione të organizatave ndërkombëtare, si: vizita e Presidentit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, z. George Tsereteli; dy delegacione nga Komisioni i Venecies; vizita faktmbledhëse e delegacionit të bashkëraportuesve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

Në datat 4–9 nëntor 2019 në Kuvendin e Shqipërisë u organizua takimi vjetor i përfaqësuesve të komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë nga parlamentet e Europës Juglindore.



Kapitulli 12

ROLI I KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës në vend, luan një rol të rëndësishëm në procesin e integrimit evropian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të tij. Kuvendi ka shprehur mbështetjen mbi përparimin e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit në rezolutat e datave 11 prill 2019 dhe 3 tetor 2019.

Gjatë vitit 2019 Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në procesin e integrimit evropian, i njohur edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian. Paketa e zgjerimit e Komisionit Evropian (*Strategjia e zgjerimit* dhe raporti vjetor 2019 për Shqipërinë), e publikuar në datën 29 maj 2019, vlerësoi progresin e vazhdueshëm që Shqipëria ka bërë në avancimin e axhendës së integrimit evropian, në veçanti rezultatet e prekshme dhe të qëndrueshme që janë arritur në plotësimin e kushteve të përcaktuara në konkluzionet e Këshillit në qershor të vitit 2018. Duke njohur dhe konfirmuar progresin e arritur nga Shqipëria, Komisioni Evropian në “*Strategjinë e zgjerimit 2019*” ripërsëriti rekomandimin e tij të pakushtëzuar për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Gjithashtu Parlamenti Evropian përmes rezolutës së datës 24 tetor 2019 mbështeti hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Gjatë vitit 2019 u miratuan ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, të cilat synojnë përmirësimin e parashikimeve të Rregullores lidhur me përafrimin e legjislacionit dhe kontrollin parlamentar në procesin e integrimit Evropian. Kjo ka sjellë sigurimin e përputhshmërisë së projektligjeve me standardet e Bashkimit Evropian si dhe rritjen e rolit kontrollues i Kuvendit në çështjet e integrimit evropian. Transparenca e veprimtarisë së Kuvendit lidhur me procesin e integrimit evropian dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në këtë proces janë rritur më tej. Kuvendi ka përmirësuar dukshëm funksionimin e strukturave nëpërmjet të cilave ushtron përgjegjësitë e tij në procesin e integrimit evropian, siç janë Komisioni i Integrimit Evropian (KIE) dhe Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian (KKIE).

Veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së

Gjatë vitit 2019 Kuvendi ka vijuar të forcojë më tej rolin e tij shqyrtues lidhur me kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara me *acquis* të BE-së, duke garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafuar. Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka luajtur Komisioni për Integrimin Evropian (KIE), i cili gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar dhe miratuar 21 projektligje, nga të cilat 12 projektligje që synojnë përafrim me *acquis* të BE-së. Komisioni i Ligjeve ka shqyrtuar dhe miratuar 1 projektligj me përafrim (projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 «Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar”). Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të 13 projektligjeve me përafrim KIE-ja dhe Komisioni i Ligjeve kanë paraqitur 48 amendamente, me qëllim përafrimin më korrekt të tyre me *acquis* të BE-së.

Gjatë vitit 2019 Kuvendi ka miratuar në seancë plenare 8 ligje me përafrim, që janë:



- ligji nr. 4/2019, datë 7.02.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, datë 31.05.2012, «Për peshkimin», i ndryshuar”;
- ligji nr. 8/2019, datë 26.02.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”;
- ligji nr. 22/2019, datë 3.04.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 «Për akuakulturën»”;
- ligji nr. 44/2019, datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, «Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar”;
- ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”;
- ligji nr. 46/2019, datë 18.07.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, «Për mbrojtjen e faunës së egër», i ndryshuar”;
- ligji nr. 56/2019, datë 18.07.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, «Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit», i ndryshuar”;
- ligji nr. 87/2019, datë 18.12.2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Veprimtaria ligjvënëse e KIE-së dhe e Kuvendit lidhur me kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara Kuvendit me *acquis* të BE-së mbështetet nga Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend.

Kontrolli parlamentar për procesin e integritit europian

Gjatë vitit 2019 roli kontrollues i Kuvendit në çështjet e integritit europian është forcuar më tej përmes përdorimit më të shpeshtë dhe më cilësor të instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Komisioni për Integrimin Europian dhe Këshilli Kombëtar i Integritit Europian (KKIE) kanë luajtur një rol të rëndësishëm për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritit europian të Shqipërisë.

Risi e vitit 2019 përbën fakti se Kuvendi zbatoi për herë të parë nenin 18, pika 1 të ligjit për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, i cili parashikon që Kuvendi, pasi shqyrton raportin vjetor të paraqitur nga Këshilli i Ministrave për ecurinë e procesit të integritit të vendit në BE gjatë vitit paraardhës, miraton në seancë plenare rezolutën përkatëse. Kuvendi në seancën plenare të datës 11.04.2019 miratoi rezolutën “Mbi progresin e Shqipërisë në procesin e integritit në Bashkimin Europian gjatë vitit 2018”, përmes të cilës: a) vlerësoi progresin e arritur gjatë vitit 2018 në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit të MSA-së dhe plotësimin e rekomandimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimit; dhe b) i kërkoi qeverisë të konsolidojë reformat e arritura dhe të thellojë më tej reformat për plotësimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim.

Në datën 3 tetor 2019 Kuvendi miratoi rezolutën “Për mbështetjen e procesit të fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, përmes të cilës: a) theksoi se angazhimi i qëndrueshëm institucional për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian dhe zbatimin e përfundimeve të Këshillit Europian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë; dhe b) ftoi vendet anëtare të BE-së që në përputhje me rekomandimet e KE-së të datës 17.04.2018, rikonfirmuar në datën 29.05.2019, si dhe përfundimet e Këshillit të Bashkimit Europian, të mbështetura nga Këshilli i Europës, të qershorit 2018, të zyrtarizojnë hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Republikën e Shqipërisë.

Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian gjatë kësaj periudhe ka vijuar të monitorojë ecurinë e procesit të integritit europian dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit. Bazuar në objektivat dhe programin e punës për vitin 2019, Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian ka realizuar:

- Në datën 11 mars 2019 takimin e radhës, që kishte në fokus bashkëbisedimin me ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme mbi ecurinë e reformave gjatë vitit 2018 në zbatim të detyrave të lëna nga Komisioni Europian dhe Këshilli i Europës si dhe për hapat që do të ndërmerren në muajt



në vijim për të mundësuar hapjen zyrtare të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

- Në datën 10 prill 2019 takimin e radhës, që kishte në fokus ecurinë e reformës në drejtësi dhe veprimtarinë e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Gjithashtu në fokus të takimit ishte edhe roli i shoqërisë civile në procesin e integritimit europian dhe përfshirja efektive e saj në vendimmarrjen publike.

- Në datën 23 prill 2019 Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, organizoi një bashkëbisedim me studentë e pedagogë të këtij Fakulteti. Ky takim u organizua në kuadër të veprimtarisë së KKIE-së për nxitjen e debatit gjithëpërfshirës me grupet e interesit mbi hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në përputhje me detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe kishte në fokus reformat e ndërmarra në kuadër të pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe respektimit të të drejtave themelore (kapitulli 23 i legjislacionit të BE-së).

- Takimin periodik në datën 18 shtator 2019, i cili kishte në fokus: 1) progresin e bërë në kuadër të përgatitjeve për negociatat e anëtarësimit në BE nga muaji mars 2019 e në vijim (kuadri nënligjor i miratuar, aspektet teknike, statusi aktual i përgatitjes së administratës publike); 2) progresi i bërë nga institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj për adresimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2019 si dhe të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë (2018), ku të ftuar ishin disa titullarë të institucioneve të pavarura, si: Avokati i Popullit, kryetari i Autoritetit të Medieve Audiovizive, kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Gjithashtu gjatë muajit shtator është finalizuar lista e rinovimit të anëtarësimit të shoqërisë civile në KKIE pas një procesi stanjacioni prej dy vjetësh. Me qëllim zgjerimin e përfshirjes dhe kontributit të shoqërisë civile, numri i përfaqësuesve të OSHC-ve në KKIE u rrit ndjeshëm në krahasim me përfaqësimin e mëparshëm, ku nga 8 përfaqësues që ishin më parë tashmë numri i tyre është 18.

- Në datën 14 tetor 2019¹ KKIE-ja zhvilloi takimin e radhës me ministrin e Brendshëm dhe Prokuroren e Përgjithshme për të informuar anëtarët e KKIE-së dhe për të diskutuar mbi progresin e realizuar në sundimin e ligjit dhe në luftën kundër krimit të organizuar, në adresimin e rekomandimeve të Komisionit Europian në raportin e vitit 2019 për Shqipërinë si dhe të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2018–2019 .

Në kuadër të përgatitjeve për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian kanë organizuar Shkollën e Integritimit Europian, e cila është e hapur për administratën publike, qeverisjen vendore, organizatat e shoqërisë civile, biznesin dhe medien. Në datat 18–22 nëntor 2019 u organizua “Raundi i katërt i Shkollës së Integritimit Europian”.

Plani i Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitet 2018 dhe 2019

Pas publikimit të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018 Kuvendi hartoi dhe miratoi Planin e tij të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të KE-së për Shqipërinë për vitin 2018. Ky Plan Veprimi përcaktoi 6 objektivat kryesorë të punës së Kuvendit për periudhën maj 2018–maj 2019 si dhe masat konkrete (46 masa) për realizimin e këtyre objektivave.

Statusi final i zbatimit të 46 masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Kuvendit deri në datën 17 maj 2019, që ishte edhe afati i fundit i parashikuar për realizimin e masave, ishte si vijon: 36 masa

¹ Procesverbal i takimit të KKIE-së mund të konsultohet në linkun:
<https://www.parlament.al/Files/Integrimi/procesverbaldate14.10.2019.pdf>



u realizuan plotësisht (ose 78,26%); 9 masa u realizuan pjesërisht (ose 19,56 %); zbatimi i një mase lidhej me hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE (masa 1,5 e objektivit II.c “Forcimi i rolit kontrollues të Kuvendit në çështjet e integritimit Europian”). Masat e Planit të Veprimit, të cilat u zbatuan vetëm pjesërisht (9 masa), janë mbartur në Planin e ri të Veprimit që Kuvendit ka hartuar dhe miratuar për zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Kuvendin në raportin e KE-së për Shqipërinë për vitin 2019.

Pas publikimit të raportit të Komisioni Europian për Shqipërinë për vitin 2019 Kuvendi hartoi dhe miratoi Planin e tij të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të KE-së për Shqipërinë për vitin 2019. Ky Plan Veprimi përcakton 6 objektivat kryesorë të punës së Kuvendit për periudhën maj 2019–maj 2020 si dhe masat konkrete (44 masa) për realizimin e këtyre objektivave. Zbatimi i masave të Planit të Veprimit monitorohet në vazhdimësi përmes raportimeve periodike që Shërbimet e Kuvendit i dërgojnë Konferencës së Kryetarëve.

Forcimi i transparencës së Kuvendit lidhur me procesin e integritimit Europian

Transparenca e veprimtarisë së Kuvendit lidhur me procesin e integritimit europian është rritur më tej. Risi e vitit 2019 në drejtim të forcimit të transparencës në procesin e integritimit europian është publikimi për herë të parë nga Kuvendi i “*Newsletter-it mbi çështjet europiane*”. *Newsletter-i* ka për qëllim t’i ofrojë lexuesit (deputetëve dhe stafit të Kuvendit të Shqipërisë si dhe publikut të gjerë) informacion gjithëpërfshirës, konciz dhe të përditësuar mbi çështjet evropiane, me fokus të veçantë në veprimtarinë e Kuvendit lidhur me procesin e integritimit europian të Shqipërisë.

Newsletter-i përgatitet nga Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit në bashkëpunim me shërbimet e tjera të Kuvendit dhe publikohet në faqen e internetit të Kuvendit çdo 3 muaj. Gjatë vitit 2019 janë publikuar numrat 1–4 të *Newsletter-it*, që mbulojnë një vit të plotë kalendarik (1 tetor 2018–30 shtator 2019) të veprimtarisë së Kuvendit lidhur me procesin e integritimit europian.

Informacione dhe kontribute të Kuvendit për procesin e integritimit europian

Kuvendi ka përgatitur dhe përcjellë informacione e kontribute të kërkuara nga institucionet e BE-së në kuadër të monitorimit të zbatimit të MSA-së BE–Shqipëri dhe të progresit në plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në BE. Në këto raportime Kuvendi ka informuar për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të BE-së që lidhen me funksionimin e Kuvendit, reformën zgjedhore dhe reformën në drejtësi.

Kuvendi ka dhënë këto informacione dhe kontribute:

- Kontributi i dytë i Kuvendit për raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2019, kapitulli “*Kriteri politik*” dhe kapitulli 23, “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*” (periudha e raportimit: 1 tetor 2018–1 shkurt 2019, dërguar në datën 15.02.2019).

- Kontributi i parë i Kuvendit për raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2020, kapitulli “*Kriteri politik*” dhe kapitulli 23, “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*” (periudha e raportimit: 1 janar 2019–31 tetor 2019, dërguar në datën 20.11.2019).

- Informacioni i Kuvendit për takimin e 11-të të Nënkomitetit BE–Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri, zhvilluar në Bruksel në datën 24 prill 2019 (periudha e raportimit: korrik 2018–mars 2019, dërguar në datën 13.03.2019).

- Informacioni i Kuvendit për takimin e dhjetë të Komitetit të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri (KSA), zhvilluar në Bruksel në datën 14 nëntor 2019 (periudha e raportimit: 26 tetor 2018– 9 shtator 2019, dërguar në datën 18.09.2019).

- Informacioni i Kuvendit për takimin e 11-të të Nënkomitetit BE–Shqipëri “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikë Sociale”, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 5 dhjetor 2019, por u shty



për në datën 20 janar 2020 (periudha e raportimit: nëntor 2018–tetor 2019, dërguar në datën 31.10.2019).

Gjithashtu Kuvendi ka dërguar në datën 30 tetor 2019 kontributin e tij në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin European (PKIE) 2020–2022, kapitulli “Kriteri politik”, pjesa lidhur me parlamentin.

SHPL-ja ka koordinuar dhe bashkërenduar punën e shërbimeve të Kuvendit për përgatitjen dhe dërgimin e informacioneve dhe kontributeve të Kuvendit në kuadër të procesit të Integritimit European. Gjithashtu SHPL-ja ka koordinuar punën me Sektorin e Përkthimit në Kuvend për të siguruar përkthimin në gjuhën angleze të informacioneve të Kuvendit, kur kjo kërkohej, si dhe ka kontrolluar cilësinë e përkthimit në anglisht të raporteve përpara se ato t’i dërgoheshin Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.



Kapitulli 13

BASHKËPUNIMI I KUVENDIT ME SHOQËRINË CIVILE


Koordinatori për shoqërinë civile dhe grupet e interesit

Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit, i miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.11.2014, përbën bazën për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në funksionin legjislativ dhe atë mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë.

Koordinatori me grupet e interesit dhe shoqërinë civile ka qenë i ftuar në dy takime në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile gjatë vitit 2019, konkretisht me *National Democratic Institute for International Affairs* dhe *Institute For Democracy and Mediation*.

Numri i organizatave të regjistruara në regjistrin elektronik të publikuara në faqen e Kuvendit të Shqipërisë është 680.

Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në vendimin nr.61/ 2018, datë 05.04.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë” (nenit 22) dhe Udhëzuesit të Detajuar për sjelljen në Kuvend, miratuar me vendimin nr. 19, datë 27.09.2018 të Byrosë së Kuvendit, në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ka publikuar regjistrin elektronik të lobistëve. Kuvendi i Shqipërisë ka bërë disa herë thirrje për regjistrimin e lobitëve, pasi nuk ka pasur interesim nga organizatat. Aktualisht pas disa thirrjeve publike në faqen zyrtare të Kuvendit janë regjistruar 42 shoqata në këtë regjistrë.



Pjesëmarrja e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë ka në përbërjen e tij 8 komisione të përhershme parlamentare. Në vitin 2019 komisionet e përhershme kanë ushtruar kompetencat e tyre në veprimtarinë parlamentare të zhvilluar, gjatë së cilës janë organizuar 153 seanca dëgjimore, nga të cilat 81 për procesin legjislativ, 19 për procesin zgjedhës, 52 për

kontrollin parlamentar dhe 1 seancë në ushtrim të funksionit të shkarkimit nga organet kushtetuese dhe të krijuara me ligj.



Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Veprimtaria e Komisionit për Çështjet Ligjore dhe nënkomisioneve në përbërje të tij edhe gjatë vitit 2019 është mbështetur në praktikën e mirë të konsultimit publik në ushtrimin e procesit legjislativ, kontrollues dhe atij zgjedhës.

Komisioni ka ftuar të marrin pjesë dhe të kontribuojnë me opinionet, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre organizata të ndryshme të shoqërisë civile, organizata dhe misione të mbështetjes ndërkombëtare, institucione të pavarura kushtetuese, ato të krijuara me ligj si dhe grupe të ndryshme interesi për shqyrtimin e disa prej projektligjeve të shqyrtuara në Komision.

Në këtë kuadër bashkëpunimi i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje në seanca dëgjimore gjatë shqyrtimit të projektligjeve rreth 166 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë rreth 65% gra dhe 35% burra. Roli i tyre ka qenë aktiv jo vetëm me pjesëmarrjen në seanca dëgjimore, por edhe me shprehjen e mendimeve, opinioneve të përcjella në adresë të komisionit lidhur me projektakte të ndryshme, një pjesë e të cilave janë reflektuar nga Komisioni. Janë marrë në konsideratë rreth 70% e amendamenteve të propozuara nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Nga 302 amendamente të miratuara në Komision, 70 amendamente janë propozuar prej tyre.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar gjithsej 47 seanca dëgjimore, nga të cilat 25 në procesin legjislativ, 16 në procesin kontrollues dhe 6 në procesin zgjedhës.

Komisioni për Integrimin European

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Integrimin European (KIE) është shqyrtimi i çështjeve të integritetit european, përafrimi i legjislacionit me *acquis* të Bashkimit European, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, mbikëqyrja e mbështetjes financiare të Bashkimit European për Shqipërinë si dhe monitorimi i negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Komisioni për Integrimin European ka zhvilluar veprimtarinë e tij në transparencë të plotë dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi. Mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar të hapura si për shqyrtimin e projektligjeve, ashtu dhe për seancat dëgjimore. Sa herë që është kërkuar nga shoqëria civile apo grupet e interesit, ato kanë marrë pjesë në mbledhjet e komisionit me të drejtë fjale. Programi i punë së Komisionit dhe rendi i ditës janë publikuar në faqen elektronike të Kuvendit. Gjithashtu sa herë që është kërkuar informacion nëpërmjet administratës së Kuvendit, ky informacion është dhënë në kohë sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.

Sipas përfaqësimit gjinor, 70% e të pranishmëve në Komisionin e Integritetit European kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 30% të gjinisë femërore.

Në tërësi Komisioni për Integrimin European ka shqyrtuar 21 projektligje, ndër të cilat 2 janë konsultuar me shoqërinë civile. Gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve kanë qenë të pranishëm disa organizata të shoqërisë civile dhe grupe interesi, respektivisht 1 për projektligjin e parë dhe 8 përfaqësi për projektligjin e dytë.

Gjithashtu Komisioni ka zhvilluar edhe 3 seanca dëgjimore.

Komisioni për Politikën e Jashtme

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Politikën e Jashtme (KPJ) është shqyrtimi i çështjeve për politikën e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

Komisioni për Politikën e Jashtme ka në përbërjen e tij edhe Nënkomisionin për Diasporën dhe



Migracionin, i cili është ngritur me vendim të Kuvendit.

Për shkak të fushës së veprimtarisë dhe specifikës së tij, Komisioni i Jashtëm nuk ka zhvilluar asnjë seancë dëgjimore ku shoqëria civile të ketë qenë pjesëmarrëse

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Ekonominë dhe Financat (KEF) është shqyrtimi i çështjeve që lidhen me politikat ekonomike, buxheti i shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, financat publike, privatizimet dhe sistemin bankar si dhe çështjet e Axhendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj.

Veprimtaria e Komisionit për Ekonominë dhe Financat edhe gjatë vitit 2019 është mbështetur në praktikën e mirë të konsultimit publik në ushtrimin e procesit legjislativ, kontrollues dhe atij zgjedhës.

Në këtë kuadër bashkëpunimi i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje në seanca dëgjimore gjatë shqyrtimit të projektligjeve rreth 9 organizata të shoqërisë civile dhe grupe të interesit, me një total prej rreth 18 përfaqësuesish, rreth 39% e të cilëve kanë qenë gra dhe 61% burra. Roli i tyre ka qenë aktiv jo vetëm me pjesëmarrjen në seanca dëgjimore, por edhe me shprehjen e mendimeve, opinionëve të përcjella në adresë të Komisionit lidhur me projektakte të ndryshme.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar gjithsej 21 seanca dëgjimore, nga të cilat 8 në proces legjislativ, 4 në proces kontrolli parlamentar, 8 në proces zgjedhës dhe 1 në ushtrim të funksionit të shkarkimit nga organet kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisioni për Sigurinë Kombëtare (KSK) është shqyrtimi i çështjeve të organizimit të mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, çështjet e bashkëpunimit ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendin publik dhe shërbimet.

Komisioni për Politikën e Jashtme ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për Vetingun e Policisë, i cili është ngritur me vendim të Kuvendit.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka zhvilluar 13 seanca dëgjimore, ndër të cilat 5 seanca dëgjimore për procesin legjislativ, 8 seanca dëgjimore për procesin e kontrollit parlamentar dhe 10 vizita jashtë institucionit, edhe këto në kuadër të kontrollit parlamentar. Gjatë zhvillimit të këtyre seancave dëgjimore ka pasur të pranishëm përfaqësues nga shoqëria civile dhe grupet e interesit, përkatësisht 114 pjesëmarrës, nga të cilët 70 meshkuj dhe 44 femra.

Nënkomisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për Vetingun e Policisë ka pasur të pranishëm në mbledhjet e tij përfaqësues nga Instituti i Studimeve Politike.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në kuadër të kontrollit parlamentar dhe në bashkëpunim me OSBE-në, ka zhvilluar 10 vizita jashtë institucionit.

Gjithashtu në bashkëpunim me disa përfaqësues të shoqërisë civile Komisioni organizoi takimin vjetor të përfaqësuesve të Komisioneve parlamentare të Sigurisë dhe Mbrojtjes të vendeve të rajonit.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (KVPTM) është shqyrtimi i çështjeve të bujqësisë, industrisë, telekomunikacioneve, turizmit, rregullimit të territorit, tregtisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

I gjithë procesi legjislativ i punës së Komisionit gjatë kësaj periudhe është realizuar me organizimin e 68 mbledhjeve, nga të cilat 26 mbledhje janë organizuar në formën e seancave dëgjimore, në të cilat



kanë qenë të ftuar përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore dhe publike, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit si dhe grupime të tjera të interesuara.

Konkretisht në Komision kanë marrë pjesë 19 grupe interesi, 7 përfaqësi të shoqërisë civile dhe 2 ekspertë të pavarur. Roli i tyre ka qenë aktiv jo vetëm me pjesëmarrjen në seanca dëgjimore, por edhe me shprehjen e mendimeve, opinioneve të përcjella në adresë të Komisionit lidhur me projektakte të ndryshme, një pjesë e të cilave janë reflektuar nga Komisioni.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin gjatë vitit 2019 është mbështetur në praktikën e mirë të konsultimit publik në ushtrimin e procesit legjislativ, kontrollues dhe atij zgjedhës. Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar gjithsej 26 seanca dëgjimore, nga të cilat 13 seanca dëgjimore në proces legjislativ, 4 seanca dëgjimore në proces zgjedhës dhe 9 seanca dëgjimore në proces kontrolli parlamentar.

Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë rreth 20% femra dhe 80% meshkuj.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (KÇSSH) është shqyrtimi i çështjeve të marrëdhënieve të punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka në përbërjen e tij edhe Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, i cili është ngritur me vendim të Kuvendit.

Veprimtaria e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe e Nënkomisionit në përbërje të tij edhe gjatë vitit 2019 është mbështetur në praktikën e mirë të konsultimit publik në ushtrimin e procesit legjislativ, kontrollues dhe atij zgjedhës. Në këtë kuadër bashkëpunimi i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje në seanca dëgjimore gjatë shqyrtimit të projektligjeve rreth 80 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit. Roli i tyre ka qenë aktiv jo vetëm me pjesëmarrjen në seanca dëgjimore, por edhe me shprehjen e mendimeve, opinioneve të përcjella në adresë të Komisionit lidhur me projektakte të ndryshme, një pjesë e të cilave janë reflektuar nga Komisioni.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar gjithsej 16 seanca dëgjimore, nga të cilat 10 në procesin legjislativ, 6 në procesin kontrollues parlamentar.

Komisioni ka ftuar të marrin pjesë dhe të kontribuojnë me opinionet, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre organizata të ndryshme të shoqërisë civile, organizata dhe misione të mbështetjes ndërkombëtare, institucione të pavarura kushtetuese, ato të krijuara me ligj si dhe grupe të ndryshme interesi për shqyrtimin e disa prej projektligjeve të shqyrtuara në Komision.

Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë rreth 40% femra dhe 60% për qind meshkuj.

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar. Dy prej tyre janë realizuar në bashkëpunim me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Aleancën e Grave Deputete.

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore gjatë vitit 2019 ka organizuar takime dhe konferenca të ndryshme në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe Aleancën e Grave Deputete me tema referuar aktivitetit të Nënkomisionit, si aspekti gjinor, vendimmarrja, gratë në parlament, buxhetimi gjinor etj.

Gjithashtu anëtarët e Nënkomisionit kanë qenë pjesë e shumë organizimeve të mbajtura nga partnerë të rajonit dhe të BE-së gjatë vitit 2019 në përputhje me axhendën e punës së Nënkomisionit.



Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Bazuar në nenin 19 të Rregullores, fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (KÇSSH) është arsimi në çdo nivel, kultura, çështjet e rinisë, shkencës, sporteve, medias së shkruar dhe asaj vizive.

Veprimtaria e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik edhe gjatë vitit 2019 është mbështetur në praktikën e mirë të konsultimit publik në ushtrimin e procesit legjislativ, kontrollues dhe atij zgjedhës.

Në këtë kuadër bashkëpunimi i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje në seanca dëgjimore gjatë shqyrtimit të projektligjeve 81 persona, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit.


Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë: 36 femra dhe 45 meshkuj, ose rreth 44% femra dhe 56% meshkuj.

Në Komision gjatë procesit të kontrollit parlamentar kanë marrë pjesë 14 grupe interesi. Roli i tyre ka qenë aktiv jo vetëm me pjesëmarrjen në seanca dëgjimore, por edhe me shprehjen e mendimeve, opinioneve të përcjella në adresë të Komisionit lidhur me projektligje të ndryshme, një pjesë e të cilave janë reflektuar nga Komisioni.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar gjithsej 28 seanca dëgjimore, nga të cilat 18 në procesin legjislativ, 9 në procesin kontrollues dhe 1 në procesin zgjedhës.

Komisioni ka propozuar dhe miratuar 111 amendamente për projektligjet që ka shqyrtuar, prej të cilëve 103 janë amendamente të propozuara nga deputetët dhe 8 amendamente nga grupet e interesit. Të gjitha amendamentet e propozuara në Komision janë miratuar në seancë plenare.

Seanca dëgjimore



- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni për Integrimin European
- Komisioni për Politikën e Jashtme
- Komisioni për Ekonominë dhe Financat
- Komisioni për Sigurinë Kombëtare
- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
- Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Seancat dëgjimore në komisionet e përhershme me ministrat, drejtuesit e institucioneve të pavarura (sipas përcaktimeve të nenit 102 të Rregullores së Kuvendit)

Komisionet e përhershme parlamentare gjatë vitit 2019 kanë zhvilluar gjithsej 151 seanca dëgjimore, të cilat përfshijnë funksionin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe funksionin zgjedhës.

Kuvendi i Shqipërisë brenda muajit maj të çdo viti publikon raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës.



Kapitulli 14

REFORMA NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Kuvendi i Shqipërisë vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në realizimin e reformës në drejtësi si në aspektin e funksionit legjislativ, ashtu dhe të funksionit zgjedhës dhe të kontrollit mbi institucionet e ngritura të sistemit të drejtësisë. Në procesin legjislativ Kuvendi i Shqipërisë ka përfunduar miratimin e paketës së dytë të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë, duke përmbyllur në këtë mënyrë një nga reformat më të rëndësishme të ndërmarra nga Kuvendi nëpërmjet Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Përfundimi i miratimit të paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi

Kuvendi i Shqipërisë miratoi 2 ligje dhe 1 vendim, që përmbyllën paketën e dytë të reformës në sistemin e drejtësisë, duke arritur numrin e përgjithshëm të ligjeve të miratuara për reformën në drejtësi në 30 ligje. Konkretisht janë miratuar: i) ligji nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”; ii) ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”; iii) vendimi nr. 47/2019 “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut 2019–2023”.

Kuvendi miratoi ndryshime ligjore në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në përmbushje të detyrimit për të zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara në këto dy ligje të paketës parësore të reformës në drejtësi kishin si qëllim: i) plotësimin e vakumit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i dispozitave të lidhura me shkeljet disiplinore të magjistratëve; b) garantimin e mirëfunksionimit normal dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si organi përgjegjës për hetimin e shkeljeve të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët; c) garantimin e mirëfunksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si organet përgjegjës për të vendosur për procedimin disiplinor të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Roli i Kuvendit në ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë

Për të garantuar mirëfunksionimin e dy prej organeve më të rëndësishme të qeverisjes së sistemit të drejtësisë: Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Kuvendi i Shqipërisë mori në analizë nevojat për burime njerëzore, investime, shpenzime etj., si dhe miratoi numrin e punonjësve të këtyre këshillave.

Komisioni për Çështjet Ligjore zhvilloi seanca dëgjimore me të gjitha organet e sistemit të drejtësisë dhe u kujdes që në buxhetin e vitit 2020 të parashikoheshin fondet e nevojshme buxhetore për garantimin e funksionimit normal të këtyre institucione bazuar në kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore.



Në ushtrim të funksionit të zgjedhjes/emërimit në organet Kushtetuese dhe ato të ngritura më ligj, bazuar në nenin 125 të Kushtetutës dhe në nenin 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës e Shqipërisë”, Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 11.11.2019 me vendimin nr. 133/2019 vendosi zgjedhjen e znj. Elsa Toska anëtare të Gjykatës Kushtetuese për vakancën e plotë të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 12.02.2018. Me vendimin nr. 134/2019 vendosi zgjedhjen e znj. Fiona Papajorgji anëtare të Gjykatës Kushtetuese për vakancën e plotë të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 4.03.2019.

Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 rishpalli thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për plotësimin e këtij vendi të lirë në Gjykatën Kushtetuese. Në përfundim të afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit janë paraqitur 6 kandidatë, dosjet e të cilëve i janë përcjellë menjëherë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED). Aktualisht KED-i po verifikon përmbushjen e kriterëve nga kandidatët.

Gjatë vitit 2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi finalizoi procedurën e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për vendin e lirë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në datën 26.12.2019 KED-i i përcolli Kuvendit të Shqipërisë listën e Kandidatëve dhe raportin e arsyetuar për procedurën e verifikimit, të vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat.

Gjatë vitit 2019 Kuvendi i Shqipërisë, pas dërgimit të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për renditjen e kandidatëve për Prokurorë të Përgjithshëm” brenda afatit kushtetues 30-ditor, në seancën plenare të datës 5.12.2019, me vendimin nr. 138/2019 vendosi të zgjedhë z. Olsian Çela Prokuror të Përgjithshëm.

Në ushtrim të funksionit kontrollues, Kuvendi ka thërritur për të raportuar Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë i Prokurorisë dhe Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Në funksion të përparimit të mëtejshëm të reformës në sistemin e drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë ka ngritur një strukturë monitoruese të pavarur, jashtë tij, që është Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në përmbushje të parashikimeve të bëra nga neni 288 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Komisioni i Pavarur gjatë kësaj periudhe është fokusuar në dy drejtime kryesore: a) monitorimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes së anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të zhvilluara pas konstituimit të Komisionit të Pavarur të Monitorimit; dhe b) koordinimin midis institucioneve dhe organeve që Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ngarkon me detyra konkrete për ngritjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Komisioni ka monitoruar ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë dhe ka bërë disa analiza dhe vlerësime, si dhe ka gjykuar të japë disa rekomandime për të ardhmen, të cilat i janë përcjellë Komisionit për Çështjet Ligjore dhe institucioneve përkatëse të sistemit të drejtësisë.

Në përfundim të monitorimit Komisioni i Pavarur ka miratuar raportet me rekomandimet përkatëse. Gjatë kësaj periudhe Komisioni i Pavarur, në ushtrim të veprimtarisë së tij monitoruese, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet përgjegjëse për ngritjen dhe funksionimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Në funksionin monitorues ka thërritur në seancë dëgjimore kryetarin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kryetarin e KLP-së dhe të KLGJ-së, si dhe ka raportuar në Këshillin Kombëtar të Integritit European në muajin mars 2019.



Kapitulli 15

ORGANIZIMET VULLNETARE

Aleanca e Grave Deputete

Aleanca e Grave Deputete është një organizim vullnetar i grave ligjvënëse të të gjitha grupeve politike në Kuvendin e Shqipërisë. Aleanca e Grave Deputete ka në vëmendje të saj arritjen e objektivit që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në pushtetin vendor minimalisht me 40% brenda 10 vjetve.

Njohja dhe respektimi i të drejtave politike për shtetasit në tërësi, duke mos përjashtuar gratë, qëndron në themel të demokracisë. Këto të drejta mbrohen nga ligjet themelore të një shteti, që janë kushtetutat e çdo vendi. Në këtë kuptim, barazia në pjesëmarrje në jetën politike luan një rol kryesor në procesin e përparimit të rolit të gruas në shoqëri. Pa pjesëmarrjen aktive dhe përfshirjen perspektive të saj në të gjitha nivelet e vendimmarrjes qëllimet e barazisë, të zhvillimit dhe paqes nuk mund të arrihen.

Aleanca e Grave Deputete për Legjislaturën IX përbëhet nga gratë deputete të grupeve parlamentare të PS-së, PD-së, LSI-së, PDIU-së. Aktualisht Aleanca e Grave Deputete përbëhet nga 36 gra deputete.

Veprimtaria me karakter legjislativ

Gjatë vitit 2019 Aleanca e Grave Deputete ka zhvilluar aktivitete të ndryshme si: *workshop*-e, pjesëmarrje në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, pjesëmarrje në aktivitete sensibilizuese, si dhe ka luajtur një rol aktiv në përmirësimin e ligjeve me ndjeshmëri gjinore, të cilat miratohen në Kuvendi për t'i përshtatur ato me standardet më të mira ndërkombëtare.

Anëtarët e Aleancës së Grave Deputete në bashkëpunim me OSBE-ODIHR-in organizuar *workshop*-in me temë “Legjislacioni me ndjeshmëri gjinore për Kuvendin e Shqipërisë”, ku fokusi kryesor ishte legjislacioni me ndjeshmëri gjinore në praktikë si dhe parimet për zbatimin e tij, standarde ndërkombëtare dhe praktika të ndryshme për barazinë gjinore dhe parlamentet me ndjeshmëri gjinore, institucionalizimi i legjislacionit me ndjeshmëri gjinore në Shqipëri etj. Në këtë *workshop* Aleanca e Grave Deputete prezantoi dhe një plan për të ardhmen, hapat që do ndërmerren më tej për të bërë një analiza gjithëpërfshirëse me bazë gjinore, si komponenti thelbësor i legjislacionit me ndjeshmëri gjinore.

Një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të Aleancës së Grave Deputete është zhvilluar në bashkëpunim me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, duke marrë pjesë në diskutimin e projektligjeve me ndjeshmëri gjinore në komisionet e përhershme parlamentare si dhe duke organizuar në bashkëpunim me këto komisione seanca dëgjimore për çështje të ndryshme me ndjeshmëri gjinore. Aleanca ka marrë pjesë dhe në seancat dëgjimore të organizuara nga Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas për buxhetimin gjinor 2020, me pjesëmarrjen e ministres së Shëndetësisë. Aleanca ka dhënë rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë, me fokus veprimtaritë e industrisë fason



në vendin tonë.

Në këtë kuadër janë dhe rekomandimet e Aleancës për Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore për përmirësimin e kuotave gjinore në legjislacionin zgjedhor, me qëllim fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore si zgjedhëse dhe të zgjedhura.

Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Demokraci (NDI) dhe mbështetjen e ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Aleanca e Grave Deputete organizuan sesionin e parë të Akademisë së Liderimit me temë “Komunikimi dhe e folura në publik” nën drejtimin e zonjës Jen Krimm, eksperte amerikane në fushën e komunikimit politik.

Bashkëpunimi rajonal dhe me organizatat ndërkombëtare

Veprimtaria e Aleancës së Grave Deputete është shtrirë si në bashkëpunim dypalësh, ashtu dhe në atë rajonal. Në mars 2019 në parlamentin e Malit të Zi u mbajt sesi i 9-të i Parlamentit të Grave të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në të cilin gratë shkëmbyen përvojat dhe angazhimet e parlamenteve të tyre në lidhje me barazinë gjinore në procesin e integritit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në muajit qershor 2019 në Shkup u zhvillua konferenca rajonale me temë “Parlamentet me ndjeshmëri gjinore”, ku u diskutua për mundësinë e bashkëpunimit rajonal si dhe u prezantua sondazhi i OSBE-së mbi dhunën ndaj grave në Europën Juglindore dhe rekomandimet përkatëse.

Në muajit tetor 2019 në Pogradec, po me mbështetjen e OSBE-së, u zhvillua një seminar dypalësh me temë “Drejt parlamenteve me ndjeshmëri gjinore”, me pjesëmarrjen e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë e të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut si dhe të stafëve të tyre mbështetëse, ku u informuan me praktikën më të mira ndërkombëtare në Slloveni, Suedi dhe në Finlandë.

Në muajin tetor 2019 në Tiranë u zhvillua konferenca rajonale “*Women’s empowerment for a peaceful Balkans and European Future*” nga *Regional Women’s Lobby in Southeast Europe*. Qëllimi i kësaj konference ishte forcimi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, ndërtimi i paqes dhe integritit evropian. Në diskutimet e tyre gratë shprehën shqetësimet për paqen dhe sigurinë e brishtë në Ballkanin Perëndimor, i cili vazhdon të kërcënohet nga institucionet e dobëta demokratike, mungesa e sundimit të ligjit, korrupsioni, rritja e ulët ekonomike, ndarja etnike dhe mosbesimi.

Gratë anëtare të Aleancës së Grave Deputete morën pjesë në forumin rajonal të barazisë gjinore, organizuar nga rrjeti “Barazi në Vendimmarrje” me mbështetjen e *National Endowment for Democracy* në kuadër të punës për nxitjen e barazisë gjinore në Shqipëri.

Në nëntor 2019 disa përfaqësues të Aleancës së Grave Deputete morën pjesë në takimin konsultativ të organizuar nga *UNFPA Albania* dhe Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave. Ky takim është pjesë e një sërë rishikimesh dhe konsultimesh me palët dhe partnerët kombëtarë të interesuar për çështje që janë aktuale, jetike dhe të domosdoshme për të marrë vëmendjen e hartuesve të politikave, partnerëve kombëtarë, OSHC-ve, partnerëve të zhvillimit, Akademisë, institucioneve mbikëqyrëse, përfshirë institucionet kombëtare të drejtave të njeriut.

Gjithashtu përfaqësues të Aleancës së Grave Deputete morën pjesë në samitin e zhvilluar në Nairobi, Samiti mbi ICPD + 25, një konferencë e nivelit të lartë që synon të mobilizojë vullnetin politik dhe angazhimet financiare të nevojshme për zbatimin e programit të veprimit të ICPD-së.

Veprimtari sensibilisuese

Një vëmendje të veçantë Aleanca e Grave Deputete u ka kushtuar aktiviteteve sensibilizuese në kuadër të javës së parandalimit të kancerit të qafës së mitrës dhe Ditës Botërore Kundër Kancerit. Në kuadër të “Tetorit Rozë” gjatë gjithë muajit Aleanca e Grave Deputete organizoi takime sensibilizuese

në disa qytete të vendit për të gjitha gratë dhe vajzat, me kryefjalë bërjen e kontrollove periodike për të luftuar në kohë këtë sëmundje dhe kancerin e gjirit, si dhe duke marrë pjesë në koncerte bamirësie me kauzën “fjongo rozë”.

Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve”

Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” (GDMF) është grupim vullnetar i deputetëve dhe nuk ka ngjyrë politike. Në kuadër të zbatimit të *Strategjisë së drejtësisë për të mitur* dhe të planit të saj të veprimit, për Grupin e Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” viti 2019 ka qenë një vit me veprimtari të larmishme. Gjatë vitit 2019 GDMF-ja ka përmirësuar të drejtën e fëmijëve përmes miratimit të legjislacionit, ka monitoruar zbatimin efektiv të politikave që sigurojnë të drejtat e fëmijëve, ka dëgjuar zërat e të rinjve dhe fëmijëve për të drejtat dhe nevojat e tyre, rinovoi strukturën dhe ruajti përbërjen e tij, me gjithë ndryshimet e deputetëve në Kuvend. Vendet e lira të krijuara në GDMF u plotësuan me deputetë të rinj.

Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” përbëhet nga 40 deputetë dhe është i organizuar në gjashtë komitete si më poshtë:

1. Komiteti për Drejtësi për të Mitur.
2. Komiteti për Bashkëpunim me OJQ-të.
3. Komiteti për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve.
4. Komiteti për Fëmijët e Vendosur në Institucionet Publike.
5. Komiteti për Buxhetin për Fëmijët.
6. Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna.

Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” ka vazhduar të zbatojë “Planin strategjik të punës 2018–2021” dhe rregulloren e miratuar në vitin 2018 me mbështetjen e UNICEF-it.

Gjatë vitit 2019 Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” propozoi për miratim në Kuvend (dhe u miratua) rezolutën “Për vlerësimin e punës së Grupit të Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” për vitin 2018 dhe planin e veprimit për vitin 2019”; propozime për përmirësimin e ligjit për ndihmën sociale dhe ekonomike, për ndryshimin e ligjit për përdorimin e kripës së jodizuar si dhe propozime për përmirësime në projektligjin “Për buxhetin e shtetit për vitin 2020”.

Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” ka organizuar mbledhje, takime, aktivitete me fëmijët, shoqërinë civile, grupet e interesit, ministra etj. si më poshtë:

- Në datën 6 mars 2019 Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve”, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, njëkohësisht kryetar i GDMF-së, prezantoi dhe miratoi raportin “Veprimtaria e Grupit të Deputetëve ‘Miqhtë e Fëmijëve’ për vitin 2018”, si dhe kalendarin e punës së Grupit të Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve” për periudhën mars–dhjetor 2019.

- Në datën 1 prill 2019 Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve”, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, njëkohësisht kryetar i GDMF-së, zhvilloi mbledhjen e radhës, ku prezantoi rezolutën “Për vlerësimin e punës së Grupit të Deputetëve ‘Miqhtë e Fëmijëve’ për vitin 2018 dhe për planin e veprimit për vitin 2019” (e cila u miratua në seancën plenare të datës 28 mars), si dhe shqyrtoi dhe miratoi raportin e pestë periodik “Për zbatimin e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve”.

- Në datën 30 shtator 2019 Grupi i Deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve”, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, njëkohësisht kryetar i GDMF-së, zhvilloi mbledhjen e radhës me objekt diskutimin e përfundimeve të raportit të monitorimit afatmesëm të Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



Takime, tryeza pune të komiteteve

Krahas mbledhjeve të Grupit të Deputetëve “Miq të Fëmijëve” veprimtari kanë zhvilluar edhe komitetet si më poshtë:

- Në datën 20 shkurt 2019 u zhvillua një tryezë pune e Komitetit për të Miturit në Konflikt me Ligjin dhe Komitetit për Marrëdhëniet me OSHC-të me objekt diskutimi sigurinë dhe incidentet me të cilat fëmijët janë ndeshur në Shqipëri gjatë vitit 2018. Përfaqësues të CRCA-së ishin të pranishëm në këtë mbledhje.

- Në datën 10 maj 2019 u zhvillua një takim midis znj. Vasilika Hysi, deputetes Klodiana Spahiu, ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Bujqësisë dhe përfaqësues të UNICEF-it lidhur me propozimet për ndryshime në projektligjin për kripën e jodizuar.

- Në datën 14 maj 2019 u zhvillua takimi i Komitetit për Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile dhe Komitetit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna. Në mbledhje u prezantuan propozimet për ndryshime në Kodin Penal, nismë e CRCA-së.

- Në datën 12 korrik 2019 Grupi i Deputetëve “Miq të Fëmijëve”, në bashkëpunim me Autoritetin e Medieve Audiovizive (AMA), organizoi tryezën “Fëmijët në medien audiovizive”. Pjesëmarrësit diskutuan për mbulimin e problematikave që lidhen me fëmijët në mediet audiovizive, si dhe u prezantua studimi i realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve mbi “Portretizimin e fëmijëve në medie: raportimi etik mbi fëmijët”. Të pranishëm ishin përfaqësues të shoqatave që kanë si objekt të punës së tyre fëmijët, AMA, ofrues të shërbimit mediatik dhe ekspertë të fushës.

Takime me fëmijët për prezantimin e raporteve të hartuara prej tyre

Në datën 14 maj 2019 gjatë takimit të dy komiteteve të GDMF-së: Komitetit për Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile dhe Komitetit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, u prezantuan propozimet për ndryshime në Kodin Penal nga zoti Altin Hazizaj, drejtor i CRCA-së, ndërsa fëmijët prezantuan raportin kombëtar “Fëmijët për të drejtat e fëmijëve”.

Gjatë takimit fëmijët dhe të rinjtë e Parlamentit Rinor prezantuan raportin e hartuar nga vetë ata mbi gjendjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve, gjatë monitorimit të udhëhequr prej tyre në zbatim të konventës “Për të drejtat e fëmijës në Shqipëri”. Ata paraqitën shqetësimet e fëmijëve dhe adoleshentët në Shqipëri që përbëjnë shkelje të të drejtave të tyre. Në këtë takim ishin të ftuar përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Avokati i Popullit.

Në datën 24 shtator 2019 u zhvillua aktiviteti i organizuar nga CRCA/ECPAT Shqipëri dhe *Save the Children* lidhur me zbatimin e nismës “Modeli i Kuvendit të Shqipërisë 2019”. Moderuan aktivitetin znj. Vasilika Hysi, zëvendëskryetare e Kuvendit; znj. Rudina Hajdari, kryetare e Komisionit për Integrimin Europian; znj. Anila Meço, përfaqësuese e *Save the Children*; z. Altin Hazizaj, drejtor i CRCA-së në Shqipëri.



Kapitulli 16

PROJEKTE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Projekti “Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar (PACEP)”

Në datën 18 qershor të 2019 shteti shqiptar, i përfaqësuar nga ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Ministrisë së Jashtme të Zvicrës, përfaqësuar nga ambasada e Zvicrës dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë nëpërmjet Prezencës së saj në Shqipëri, nënshkruan marrëveshjen për projektin “Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar (PACEP)”.

Projekti ka për qëllim të forcojë Kuvendin e Shqipërisë në kryerjen e funksionit legjislativ, mbikëqyrës dhe përfaqësues në mënyrë sa më efektive. Ky projekt gjithashtu synon nxitjen e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

Partnerët zbatues të këtij projekti do të jenë organizata jofitimprurëse NDI dhe organizata ndërqeveritare OSBE. Projekti i SDC-së parashikon edhe përfshirjen e shërbimeve parlamentare zvicerane, që do të ndajnë eksperiencën e tyre me shërbimet e Kuvendit të Shqipërisë, duke qenë se kanë bërë një vlerësim paraprak të nevojave të institucionit.

Projekti PACEP ka përfunduar fazën e parë të vlerësimit dhe konceptimit dhe ka nisur faza e zbatimit të aktiviteteve.

Qëllimi i përgjithshëm: qytetarë më të vetëdijshëm dhe të edukuar fuqizohen që të marrin pjesë aktive në proceset vendimmarrëse në vend dhe të përfitojnë nga një parlament funksional dhe përfaqësues.

Rezultati 1: administrata e Kuvendit përmbush funksionet e saj në mënyrë efektive dhe efektive.

Rezultati 2: përmirësim i funksionit mbikëqyrës dhe përfaqësues të Kuvendit, nëpërmjet llogaridhënies së qeverisë dhe përmirësimit të përfaqësimit të zgjedhësve.

Rezultati 3: qytetarët duhet të kenë hapësirën e tyre në zhvillimin demokratik të vendit; ata janë të përgatitur të kërkojnë llogari nga deputetët dhe të jenë aktivë në reforma.

Gjithashtu projekti do të mbulojë aktivitete që synojnë asistencë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Organizatat e Shoqërisë Civile, institucionet e pavarura, zgjedhësit dhe qytetarët.

Dy partnerët do të zbatojnë projektin për një periudhë katërvjeçare. Më poshtë do të gjeni listën e plotë të aktiviteteve që do të mbulojë ky projekt.

Me nënshkrimin e marrëveshjes për projektin është bërë punë përgatitore mbi disa nga aktivitetet, zbatimi i plotë i të cilave do të bëhet në vijim:

Plani strategjik

Plani strategjik është konsideruar si aktiviteti që do t'i japë udhë projektit dhe veprimtarisë së Kuvendit. Është formuar një grup pune, i cili po ndjek procesin e planifikimit. Është hartuar një plan pune me afate të mirëpërcaktuara dhe ka filluar zbatimi i tij.



Qendra e vizitorëve

Është identifikuar një hapësirë në ambientet e godinës së seancave plenare, që do të përdoret si qendër vizitorësh dhe njëkohësisht qendër trajnimi. NDI-ja do të ndjekë procedurat e prokurimit për përshtatjen dhe mobilimin e sallave, ndërsa shërbimet e Kuvendit do të angazhohen në hartimin e përmbajtjes së aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë qendër.

Mentorimi i Kërkimit Parlamentar

Drejtuues të instituteve parlamentare të rajonit dhe Europës kanë trajnuar dhe këshilluar nëpunësit e Kërkimit Parlamentar. Produktet e para kërkimore, sipas standardeve europiane të kërkimit parlamentar, janë në përfundim dhe do t'u dorëzohen deputetëve në ditët në vijim.

Programi i praktikantëve për administratën

Pesë praktikantë të përzgjedhur sipas kriterëve të caktuara nga NDI-ja janë vendosur pranë nëpunësve të administratës për të asistuar gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Shërbimet parlamentare zvicerane - Edukimi qytetar

Nëpunësit e parlamentit zviceran kanë ofruar ndihmën e tyre dhe kanë përcjellë përvojën që kanë në çështjet e edukimit qytetar. Nëpërmjet kësaj ndihme është hartuar një skenar për turin e Kuvendit, i cili do të pasurohet në vazhdim me ture të specializuara. Do të bëhet në muajt në vazhdim një tur virtual i Kuvendit, nga i cili qytetarët mund të vizitojnë *on-line* ambientet e Kuvendit nga shtëpia e tyre. Do të bëhen periodikisht aktivitete me nxënësit e shkollave në formën e simulimit të miratimit të ligjit dhe debateve në komisione dhe seancë plenare.

Shërbimet parlamentare zvicerane - Mbikëqyrja/kontrolli parlamentar

Parlamenti zviceran ka komisione kontrolli, që ushtrojnë veprimtari mbikëqyrëse dhe kontrolluese mbi ekzekutivin. Këto komisione e detajojnë punën e tyre në një udhëzues të komisioneve dhe stafit mbështetës. Është menduar që Kuvendi i Shqipërisë të hartojë një udhëzues të ngjashëm, që të detajojë procedurat e kontrollit ndaj ekzekutivit, si dhe të krijojë formate standarde për raportimin e këtij kontrolli. Në fund të këtij viti do të jetë hartuar një draft fillestar i udhëzuesit.

Mbështetja dhe koordinimi i projektit

Bordi Këshillimor i Projektit (BKP)

Me qëllim që të sigurohet mbështetje e përgjithshme e projektit, si dhe të trajtohen çështjet e politikave, është themeluar Bordi Këshillimor i Projektit (BKP), që do të mbledhet dy herë në vit (në qershor dhe në nëntor). BKP-ja do të mbështesë projektin dhe do të japë zgjidhje për problemet e rëndësishme të zbatimit; do të shqyrtojë rregullisht arritjet e projektit dhe do të bëjë komente lidhur me zhvillimin e tij. Bordi u mbledh për herë të parë më 15 nëntor 2019. Anëtarë të Bordit janë zëvendëskryetarja e Kuvendit, ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin, ambasadori i Zvicrës, ambasadori i OSBE-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, drejtori ekzekutiv i NDI-së, përfaqësues të grupeve parlamentare.



Komisioni Teknik i Kuvendit

Komisioni Teknik i Kuvendit do të garantojë ndjekjen e projektit, do të mbështesë procesin e zbatimit dhe planifikimit të projektit, do të udhëheqë diskutimet teknike për çështjet e rëndësishme, do të miratojë rezultatet kryesore të projektit, do të drejtojë zbatimin e projektit sipas prioriteteve të Kuvendit të Shqipërisë dhe do të koordinojë të gjitha aktivitetet e planifikuara. Komisioni Teknik i Kuvendit mund të mbledhet mbi baza *ad hoc* sipas nevojës si dhe me kërkesë të njërit prej anëtarëve. Anëtarë të Komisionit janë përfaqësues nga kabineti i Kryetarit të Kuvendit, përfaqësues nga Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin, përfaqësues nga zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, përfaqësues nga ambasada zvicerane, përfaqësues nga OSBE-ja dhe përfaqësues nga NDI-ja.

Rrjeti i të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore i Komisioneve Parlamentare (HUGEN)

Gjatë vitit 2019 Kuvendi i Shqipërisë u bë pjesë e rrjetit të komisioneve parlamentare të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore (HUGEN) në Ballkanin Perëndimor (BP), mbështetur nga Fondacioni “Uestminster për Demokraci”, mbështetur dhe financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe do të përfshijë komisione parlamentare nga tetë parlamente nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Programi zbatohet nga zyra rajonale e WFD-së në Beograd në bashkëpunim me zyrat e WFD-së në të gjithë rajonin.

Programi do të mbështesë deputetët dhe stafin parlamentar në forcimin e bashkëpunimit parlamentar në rajon dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të parlamenteve; do të përmirësojë kulturën për të kryer një mbikëqyrje efektive për zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore; do të mundësohet shkëmbimi rajonal *peer-to-peer* i njohurive dhe praktikave më të mira; organizatat e shoqërisë civile, stafi akademik dhe palët e interesuara që punojnë për të drejtat e njeriut dhe c’ ~ështjet gjinore do të përfitojnë nga programi duke u angazhuar me parlamentet, në mënyrë që të përparojnë gjendjen aktuale të zbatimit të të drejtave të njeriut dhe legjislacionit gjinor.



Kapitulli 17

ADMINISTRIMI

Financat dhe buxheti

Burimi kryesor i financimit të shpenzimeve të Kuvendit është buxheti i shtetit. Buxheti i vitit 2019 është miratuar me ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

Ky buxhet akordohet në bazën e klasifikimeve buxhetore që kanë të bëjnë me:

- Klasifikimin administrativ, kodi “02” tregon se është buxheti i Kuvendit të Shqipërisë.
- Klasifikimin sipas programeve buxhetore. Buxheti i Kuvendit planifikohet dhe akordohet në dy programe kryesore buxhetore: programin e veprimtarisë legjislativë e të diplomacisë parlamentare dhe programin buxhetor administrativ (planifikim, menaxhim, administrim).
- Klasifikimin sipas burimeve të financimit. Për vitin 2019 financimi i aktivitetit të Kuvendit është bërë vetëm nga buxheti i shtetit.
- Klasifikimin funksional sipas objektivave të vendosura në institucion.
- Klasifikimin ekonomik, i cili përcakton buxhetin sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve (pagat, kontributet e sigurimeve, blerje mallra e shërbime, investime etj.)
- Kodin e produktit, që identifikon totalin e shpenzimeve në funksion të një produkti (outputi).

Kuvendi i Shqipërisë nuk gjeneron të ardhura përveç të ardhurave jashtë limitit. Këto të ardhura për vitin 2019 ishin 11.934.510 lekë dhe janë të ardhura të paplanifikuara, që kanë të bëjnë me shitjen e shtypshkrimeve, kalimin në buxhetin e shtetit të ndalesave që bëhen për mungesat e papërligjura në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve parlamentare, të ardhura nga zhdëmtimet për kompjutera të dëmtuar, të padorëzuar nga personat përgjegjës dhe mjetet në ruajtje (ndalesat 5% të faturës për garanci cilësie në rastet e investimeve). Të ardhurat jashtë limit transferohen në buxhetin e shtetit, ndërsa mjetet në ruajtje rakordohen me thesarin dhe u transferohen subjekteve përkatëse, pasi analizohet që investimi i bërë ka qenë brenda kushteve të cilësisë dhe ka plotësuar kërkesat e Kuvendit.

Planifikimi buxhetor në kuadër të projektbuxhetit afatmesëm 2020–2022

Programi buxhetor afatmesëm 2020–2022 i Kuvendit të Shqipërisë është hartuar sipas ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; ligjit nr. 10.296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Programi buxhetor afatmesëm i Kuvendit të Shqipërisë mundëson:

1. Krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve institucionale dhe prioriteteve në shpenzime, me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion.
2. Inkurajimin e efektivitetit,



eficiencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve.

3. Forcimin e disiplinës fiskale, duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

4. Zgjerimin e vizionit të procesit të buxhetimit, duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

Procesi i hartimit të PBA-së është i orientuar mbi bazën e performancës. Kjo mënyrë e konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsiston në përmbushjen e objektivave të politikës nëpërmjet produkteve të matshme dhe aktiviteteve të kostueshme.

Zbatimi i buxhetit të vitit 2019

Buxheti i Kuvendit për vitin 2019 është miratuar me ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe ka pësuar ndryshime me aktin normativ nr. 2, datë 2.10.2019 dhe aktin normativ nr. 11, datë 24.12.2019.

Tabela më poshtë paraqet planin buxhetor fillestar, planin buxhetor përfundimtar (sipas akteve normative) dhe realizimin faktik:

Zërat buxhetorë	Plani buxhetor sipas ligjit 99/2018	Plani buxhetor përfundimtar	Realizimi faktik	% e realizimit të buxhetit ndaj planit përfundimtar
a	1	2	3	4=3/2
Programi i veprimtarisë ligjvënëse				
Shpenzime për paga	332	262	243	92,75%
Shpenzime për sigurimet shoqërore	47	45	32	71%
Shpenzime për mallra dhe shërbime	331	326	245	75,15%
Kuota parlamentare	15	15	12	80%
Transferta individëve (paga të menjëhershme)	0	22	20	90,9%
	725	670	552	80%
Programi i veprimtarisë administrative				
Shpenzime për paga	224	198	185,2	93,53%
Shpenzime për sigurimet shoqërore	37	38	29,4	77,36%
Shpenzime për mallra dhe shërbime	158	144	102,5	71,18%
Transferta me jashtë	0,97	0,97	0,25	25,77%
Transferta individëve (paga të menjëhershme)	0	0,4	0,4	100%
Shpenzime kapitale nga buxheti i shtetit	180	180	61,3	34%
	599	561	379	67,56 %
Buxheti vjetor i Kuvendit	1324	1231	931	75,63 %



Gjatë vitit 2019, për shkak të dorëzimit të mandateve nga deputetët e opozitës (si rrjedhojë dhe stafi politik i saj) si dhe dorëzimi i mandateve nga deputetë që kandiduan në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të qershorit 2019, Kuvendit i janë akorduar 22 milionë lekë fond për pagat e menjëhershme që parashikon ligji nr. 9061, datë 8.05.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 «Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit», ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.06.2000”. Ky fond është realizuar në masën 20 milionë lekë.


Gjithashtu, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor dhe brenda tavanit të miratuar nga Ministria e Financave, janë përdorur si fond i veçantë 460 mijë lekë, nga të cilat 210 mijë lekë për raste vdekjesh të familjarëve, 15 mijë lekë për dëmtim në punë të punonjësve, 110 mijë lekë për raste të rënda shëndetësore dhe 125 mijë lekë për dalje në pension.

Shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se këta dy zëra së bashku janë realizuar në masën 74,15%. Gjatë vitit 2019:

- Në muajin shkurt 58 deputetë të opozitës dorëzuan mandatet dhe stafi politik dha dorëheqjen.
- Një pjesë e punonjësve të zyrave zgjedhore janë rekrutuar në periudha të ndryshme gjatë vitit buxhetor, duke çliruar fond page.
- Numri i punonjësve politikë nuk është i plotësuar sipas strukturës dhe planifikimit të pagave.
- Ka pasur vende të lira në pozicione drejtuese, këshilltarë dhe specialistë, nëpunës civilë. Për ta duhet të merren masa nga Burimet Njerëzore për kryerjen e procedurave të rekrutimit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet realizimin e buxhetit në zërin “shpenzime për paga dhe kontributet e sigurimeve”:



Fondi i pagave për vitin 2019 ka qenë i planifikuar për 405 punonjës (deputetë, staf politik dhe administrativ), ndërsa numri faktik për të cilin janë bërë shpenzimet ka qenë mesatarisht 332.

Gjatë vitit 2019, si rezultat i analizave të çlirimit të fondeve, janë kthyer në buxhet 100 milionë lekë nga fondet e pagave të pushpenzuara, duke u miratuar me aktet normative.



Shpenzimet për blerje materiale dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Për vitin 2019 ky zë shpenzimesh, i cili përfshin një gamë të gjerë shërbimesh dhe blerjesh, është realizuar në masën 69,73% në total.

Grupi më i madh në këtë zë buxhetor janë shpenzimet që sanksion “statusi i deputetit” dhe vendimi 114/2014 i Kuvendit “Për trajtimin e deputetëve”. Në këtë zë përfshihen rimbursimet për telefoninë; shpenzimet për karburantin (parashikuar në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë, i ndryshuar”); dieta ditore brenda vendit (kundrejt vetëdeklarimeve që plotësojnë deputetët për aktivitete parlamentare); trajtime për qira banese (për vitin 2019 kanë përfituar 20 deputetë, kundrejt plotësimit të dokumentacionit që kërkohet); honorare për mbledhjet e komisioneve parlamentare (pagesat kryhen sipas numrit faktik të mbledhjeve dhe pjesëmarrjeve që janë evidentuar, pa tejkaluar numrin maksimal të mbledhjeve që përcakton vendimi i Kuvendit).

Planifikimi vjetor për këtë grup shpenzimesh kap vlerën 196 milionë lekë, por realizimi është më i ulët. Për vitin 2019 vlera e realizuar në këtë grup shpenzimesh është 145 milionë lekë ose 76% e planifikimit.

Gjatë vitit 2019 janë paguar dhe honorare për Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vlerën 4,5 milionë lekë.

Shpenzime për udhëtime jashtë shtetit janë realizuar në vlerën vjetore 56,3 milionë lekë, nga të cilat 31,2 milionë lekë janë shpenzuar për bileta transporti ajror dhe 25 milionë shpenzime fjetje dhe dieta ditore për udhëtimet jashtë shtetit, shpenzime këto konform kuotave dhe përcaktimeve të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Kuvendi nuk ka një akt ligjor, nënligjor ose administrativ që të trajtojë në mënyrë specifike deputetët, këshilltarët dhe nëpunësit e Kuvendit, pavarësisht mangësive që paraqet kuadri ligjor në fuqi.

Gjatë vitit 2019 janë lëshuar rreth 120 urdhra udhëtimi për rreth 215 persona, në të cilët theksohet lloji i aktivitetit, përbërja e delegacionit pjesëmarrës, itinerari i udhëtimit dhe cilat shpenzime mbulon Kuvendi i Shqipërisë.

Shpenzime për pritje, përcjellje të delegacione të huaja është grupi i shpenzimeve që përfshin akomodim, dreka dhe takime zyrtare të delegacioneve parlamentare të huaja në Shqipëri. Për vitin 2019 janë realizuar rreth 4,5 milionë lekë shpenzime për pritje. Këto shpenzime planifikohen mbi bazën e një programi të vizitës zyrtare apo aktivitetit dhe miratohen paraprakisht. Kuadri ligjor që parashikon këto shpenzime është VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar në vitin 1999.

Shpenzime për botime parlamentare

Realizimi i shpenzimeve faktike për vitin 2019 është 15 milionë lekë, pavarësisht se fatura e fundit nuk është likuiduar për shkak të mbylljes së veprimeve në Thesar para datës së përfundimit të kontratës (31.12.2019).

Peshën kryesore në këtë zë e zënë botimet: revista “Kuvendi”, botimet e reformës në drejtësi, 15 botime me fjalime të kryetarëve të Kuvendit dhe të kryeministrave të Shqipërisë, botuar në kuadër të 100-vjetorit të parlamentarizmit, si dhe aktet e shtetit shqiptar për vitet 1920–1924.

Shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve elektronike, godinave, autoveturave dhe pajisjeve të tjera (ashensorë, tra sigurie, motogjenerator)

Ky grup shpenzimesh rezulton në vlera të konsiderueshme (40 milionë lekë) për shkak të nevojave për mirëmbajtje të sistemeve të tilla si: sistemi *e-parlament* (për vitin 2019 janë shpenzuar 20,3 milionë



lekë; sistemi elektronik i votimit, sistemi audio-video (për vitin 2019 nuk janë shpenzuar lekë, pasi u instalua nga IPA një sistem i ri, i cili do të fillojë mirëmbajtjen në vitin 2020); sistemi i sigurisë me kamera (nuk janë planifikuar fonde për vitin 2019, por do të mirëmbahen në vitin 2020 e në vazhdim); rrjeti *wireless* (shpenzuar në vitin 2019 vlera 4,2 milionë lekë); mirëmbajtje e godinave në vlerë 4 milionë lekë; mirëmbajtje e autoveturave, 5 milionë lekë; mirëmbajtje e pajisjeve të tjera, si kondicionerë nëpër zyra, gjeneratori, fotokopjatriçet, skanerat e sigurisë; ashensorët etj., për të cilat janë shpenzuar 6,5 milionë lekë.

Rritja e vlerës së këtyre shpenzimeve nga viti në vit shpjegohet me amortizimin e pajisjeve dhe sistemeve ekzistuese, që kërkojnë shpenzime për shërbim mirëmbajtjeje në rritje dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” për sigurimin e mirëmbajtjes së planifikuar gjatë 2–4 vjet”. Gjatë vitit 2019 nuk është bërë mirëmbajtje e sistemit audio-video, pasi në Kuvend sistemi audio-video i vitit 2007 është vlerësuar për t’u tjetërsuar dhe është punuar me sistemin audio-video të investuar me fondet e IPA 2014 në 8 sallat e komisioneve parlamentare. Në vitin 2019 ky sistem është regjistruar në asetet e Kuvendit.

Gjatë vitit 2019 është instaluar sistemi audio-video edhe në sallën e mbledhjeve të grupeve parlamentare.

Shpenzime për energji elektrike, ujë, shërbime postare dhe telefoni

Realizimi i këtyre shpenzimeve nga viti në vit kanë qenë në rënie.

Duhet theksuar se Kuvendi nuk ka realizuar shpenzime për telefoninë celulare të nëpunësve që përfitojnë nga VKM-ja nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”. Kjo për faktin se ky vendim (pika 14) ka krijuar problematika në funksionim, duke filluar që mënyra e prokurimit.

Shpenzime për blerje karburanti për autoveturat

Kuvendi i Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshjen kuadër nr. 3689/26, datë 27.03.2019 me shoqërinë “Kastrati sh.p.k” dhe shoqërinë “Kastrati sh.a” me një afat deri më 31.12.2020.

Gjatë vitit 2019 janë paguar 14,3 milionë lekë shpenzime karburanti (kujtojmë se gjatë viti 2018 nuk ka pasur pagesa për blerje karburanti për shkak të mosrealizimit me sukses të procedurave të prokurimit për këtë blerje).

Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Janë shpenzuar 23,6 milionë lekë në këtë nëngrup, duke ekzekutuar përfundimisht vendimet gjyqësore ndaj 5 ish-punonjësve (vlera 9,9 milionë lekë), ekzekutimi përfundimtar i vendimeve ndaj 5 ish-deputetëve të opozitës së vitit 2009 (detyrimi shtator 2009–maj 2010) dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore ndaj 8 ish-deputetëve të opozitës për ndalesat konform ligjit “Për statusin e deputetit” dhe vendimit nr. 114/2014 të Kuvendit “Për trajtimin e deputetëve” për mungesat në vitin 2014 dhe në vitin 2017 (periudha bojkoti).

Shpenzime për blerje kancelari, materiale pastrimi, hidraulike, elektrike, tonera për printerat etj. gjithsej 12,7 milionë lekë.

Shpenzime të tjera kanë të bëjnë me taksa, siguracione për autovetura dhe godina, dekorime, pagesa të përkthyesve në gjuhë të huaja, pagesa për komisione *ad hoc* që marrin pjesë në proceset e rekrutimit



të burimeve njerëzore, blerje dhurata apo lule e kurora (sipas rastit dhe me kërkesë të Shërbimit të Protokollit Zyrtar) etj.

Duke qenë se në janar 2020 do të kremtohet 100-vjetori i parlamentarizmit, administrata e Kuvendit ka marrë masat për realizimin e aktiviteteve përgatitore, në të cilat janë përfshirë dhe institucione të tjera.

Gjatë vitit 2019 me kërkesë të Kuvendit janë rishpërndarë fonde, duke i mundur aktorëve në proces realizimin e aktiviteteve sipas programit të miratuar në Byronë e Kuvendit.

Me akt normativ i janë kaluar 350 mijë lekë Akademisë së Studimeve Albanologjike; 740 mijë lekë Akademisë së Shkencave; 1,1 milion lekë Muzeut Historik Kombëtar; 3 milionë lekë Institutit të Historisë; 1,3 milion lekë Bashkisë së Lushnjës.

Shpenzimet për kuotat parlamentare janë realizuar në vlerën 12,3 milionë lekë.

Kuvendi i Shqipërisë është anëtar me të drejta të plota në organizata shumëpalëshe ndërkombëtare dhe asamblatë përkatëse të këtyre organizatave. Një detyrim që lind pas anëtarësimit në këto organizata është dhe pagesa e kontributeve vjetore.

Mospagesa e kuotave të anëtarësisë sjell penalitete, të cilat çdo organizatë i ka të përcaktuara qartë të rregulloret e funksionimit të tyre, ku përfshihen: heqja e së drejtës për pjesëmarrje në organe të organizatës, heqja e së drejtës së votës për delegacionin e parlamentit që nuk bën pagesat etj.

Investimet kapitale

Ligji “Për buxhetin e vitit 2019” i ka akorduar Kuvendit 180 milionë lekë shpenzime kapitale. Projektet e akorduara me financim të brendshëm (buxheti i shtetit) paraqiten në tabelën më poshtë (në mln. lekë), ku plani paraqitet duke marrë në konsideratë ndryshimet e kërkuara gjatë vitit (rishpërndarjet):

Emërtimi projekteve	Plani	Fakti	Diferenca	Komente
a	1	2	3=1-2	4
Sistemi elektronik i votimit	60.5	13	47,5	Vazhdon në vitin 2020
Sistemi i funksionimit të infrastrukturës së klasifikuar	8	0	8	Nuk u realizua
Sistemi për dixhitalizimin e aseteve mediatike	15.9	0	15,9	Nuk u realizua
Sistemi i menaxhimit dhe administrimit të dokumentacionit	18.6	3,6	15	Vazhdon në vitin 2020
Platforma ndërinstitucionale e monitorimit	4.6	4,6	0	I përfunduar
Përmirësimi i sistemit të rrjetit network (firewall)	3	2,9	0,1	I përfunduar
Sistemi audio-video në sallën e mbledhje të grupeve parlamentare	9.6	9,5	0,1	I përfunduar
Pajisje zyre të blera	17.8	5,29	12,51	Nuk u realizua blerja e kompjuterave të planifikuar
Blerje autoveturash	38	18,5	19,5	Vendimi i Byrosë nr. 32, datë 17.01.2019
Mbikëqyrje, kolaudim punimesh (detyrim vitit 2018)	0.09	0,09	0	Mbyll detyrimin e vitit 2018
Aplikacion Kuvendi Shqipërisë (kontratë e vitit 2018)	3.7	3,7	0	I përfunduar
Projekt për mbrojtjen ndaj zjarrit në Kryesi	0.14	0,12	0,02	I përfunduar
Totali investimeve	180	61,3	118,7	



Sistemi elektronik i votimit në sallën e seancave plenare, investim i rëndësishëm për funksionin e Kuvendit, parashikuar me fondet e investimeve të vitit 2019, u zhvillua si projekt, ndoqi procedurat e nënshkrimit të kontratës, janë pranuar një pjesë e pajisjeve sipas grafikut përkatës gjatë vitit buxhetor. Për këtë sistem zhvillimi konfigurimet e tjera të nevojshme do të bëhen gjatë vitit 2020, deri në marrjen në dorëzim të këtij investimi. Do të përdoren fondet e investimeve për vitin 2020.

Blerja *software & hardware* për menaxhimin dhe administrimin e dokumenteve përmes ndërtimit të sistemit *Case and Document Management* do të mundësojë rritjen e eficiencës në punë të stafit të Kuvendit, shpejtësinë e gjetjes së materialeve dhe shkresave, dixhitalizimin e proceseve, ruajtjen, editimin, magazinimin dhe arkivimin e dokumenteve të prodhuara, minimizimin e përdorimit të letërës dhe inputeve të tjera për printimin e shkresave të ndryshme, ndjekjen e progresit të çështjeve të brendshme dhe nxjerrjen e statistikave mbi indekset e performancës.

Gjatë vitit 2019 u realizuar procedura, u lidh kontrata, janë pranuar dhe instaluar pajisjet *hardware* dhe janë bërë likuidimet. Procedurat që lidhen me programin, konfigurimet e tij sipas mënyrës se si funksionon administrata e Kuvendit, trajnimi i të gjithë përdoruesve dhe të tjera karakteristika (features) do të likuidohen me fondet e vitit 2020.

Sistemi për digjitalizimin e aseteve mediatike, rrjeti kompjuterik i klasifikuar, pajisje portabël dhe sistemi portabël i përkthimit, u ndoqën hapat përkatëse, por nuk u përfunduan në nënshkrim kontrate, pasi procedurat u ndërprejnë për shkak të fatkeqësisë natyrore të 26 nëntorit 2019.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të vitit 2019

Raportet e monitorimit synojnë paraqitjen e performancës gjatë zbatimit të buxhetit, duke dhënë informacion në terma sasiorë dhe vlerorë të produkteve të realizuara.

Gjatë vitit 2019 Kuvendi ka hartuar raportet e monitorimit çdo katërmujor, i ka shoqëruar ato me analizat përkatëse, analiza krahasuese që bën Shërbimi i Financës dhe Buxhetit dhe analizat e performancës që realizojnë ekipet e menaxhimit të programeve. Pas miratimit në Byronë e Kuvendit këto raporte janë publikuar në faqen zyrtare.

Transport i garantuar

Është siguruar gatishmëria teknike e autovecurave në dispozicion të Kryesisë së Kuvendit në nivele optimale, duke garantuar një shërbim në kohë dhe me cilësinë e duhur për lëvizjet brenda dhe jashtë vendit. Me mjetet e reja të blera gjatë viteve 2017–2019 janë mbuluar 14 udhëtime të delegacioneve parlamentare shqiptare dhe stafit të Kuvendit në vendet e rajonit: në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë, në Malin e Zi dhe Serbi.

Po ashtu sipas programeve janë shoqëruar 7 delegacione ndërparlamentare që kanë zhvilluar vizita zyrtare dhe punë në parlament.

Ka vijuar zëvendësimi i autovecurave të institucionit dhe me fondet e vitit 2019 u blenë 5 mjete të reja, por me vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 32, datë 17.01.2019 u vendos përdorimi vetëm 50% i fondit për këtë qëllim.

Gjatë kësaj periudhe është realizuar transferimi kapital i 7 autovecurave dhe 1 minibusi si rezultat i realizimit të blerjeve të makinave të reja sipas një planifikimi afatmesëm. Po vijon vlerësimi edhe për 5 mjetet.

Gjatë vitit janë garantuar shërbimet e specializuara për mirëmbajtjen dhe sigurinë e automjeteve që janë pjesë e inventarit të Kuvendit.



Kushte pune të përshtatshme

Veprimtaria parlamentare ushtrohet në ambiente relativisht të mëdha, në disa ndërtesa dhe rreth 200 zyra pune, salla pritje, mbledhje për konferenca, salla për medien, salla e seancave plenare, salla të përshtatshme me sisteme audio-video për mbledhjet e komisioneve të përhershme parlamentare, hapësira korridore, tualete, magazina, park automjesh. Me administrim të burimeve njerëzore, por edhe me shërbime nga të tretë, janë garantuar kushte higjienosanitare si dhe shfrytëzim me efektivitet i mjeteve elektromekanike.

Prokurimet

Menjëherë pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2019, në zbatim të rregullave të prokurimit publik, bazuar në legjislacionin në fuqi Shërbimi i Prokurimeve në bashkëpunim me shërbimet e tjera të Kuvendit përgatiti regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2019.

Ky regjister është i publikuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe një kopje degës së Thesarit. Pas botimit të regjistrin të parashikimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik, Shërbimi i Prokurimeve në bashkëpunim me drejtoritë e linjës filloi punën për plotësimin e dokumentacionit për shpalljen e procedurave dhe realizimin e mallrave/shërbimeve të kërkuara. Për vitin 2019 janë shpallur 21 procedura prokurimi për blerje të mëdha, 176 procedura për blerje të vogla dhe 13 procedura nën 100.000 lekë. U ndoqën standardet e zhvillimit të procedurave me mjete elektronike nëpërmjet sistemit *on-line* të APP-së në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Zyra e Protokollit

Gjatë vitit 2019 është përpunuar dokumentacioni, shkresat zyrtare (pa praktikat me fraksion), si më poshtë:

- dokumentacion i krijuar në institucion: 5181 copë;
- dokumentacion i ardhur: 2301 copë;
- ftesa, revista, kartolina, letra populli, botime të ndryshme për kryetarin e Kuvendit: 461 copë;
- ftesa për deputetët: 1359 copë;
- letra nga populli për deputetët: 451 copë;
- revista, fatura, materiale të tjera: 1431 copë.

Burimet njerëzore

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil, i ndryshuar”, neni 18, “Plani vjetor i pranimin në Shërbimin Civil”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil” dhe vendimeve të Byrosë së Kuvendit për miratimin e ndryshimeve në strukturë në vitin 2015, 2016 dhe 2017, “Plani vjetor i pranimeve në Shërbimin Civil të Kuvendit për vitin 2019 është si më poshtë:

- niveli i lartë drejtues - 3;
- niveli i mesëm drejtues - 1 drejtor;
- niveli i mesëm drejtues - 11 këshilltarë dhe 1 shef sektori;
- niveli ekzekutiv - 30 specialistë dhe sekretarë në stafin politik.

Larguar gjatë vitit 2019 nga institucioni i Kuvendit, niveli drejtues, niveli ekzekutiv dhe stafi politik:

- niveli i lartë drejtues – 3;



- niveli i mesëm drejtues -10 (këshilltarë dhe këshilltarë politikë) dhe 2 shefa sektori;
- niveli ekzekutiv - 29 specialistë dhe sekretarë në stafin politik;
- Në zbatim të planit të punonjësve të përkohshëm me kontratë - 9 punonjës në shërbime të ndryshme;
- dalje në pension - 2 nëpunës

Autoriteti i ulët pranë Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka zbatuar afatet e përcaktuara në ligj për mbledhjen e deklaratave të pasurisë dhe dorëzimin pranë ILDKPKI-së.

Formularët e vlerësimit të punës për 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë plotësuar nga të gjitha shërbimet.

Gjatë vitit 2019 është bërë njoftimi në kohë i subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit të pasurisë, duke sqaruar afatet ligjore që duhet të respektohen nga ana e tyre. Njoftimet për deklarimin e pasurisë janë bërë me shkresa zyrtare, bashkëlidhur të cilave është shpërndarë dhe një shpjegues, në të cilin detajohet mënyra e plotësimit të deklaratës së pasurisë. Gjithashtu njoftimi është bërë edhe elektronikisht në adresat e tyre private dhe zyrtare, në të cilat janë dërguar edhe formularët e deklarimit të pasurisë për çdo subjekt. Dorëzimi i formularëve të deklarimit periodik vjetor është bërë brenda afateve ligjore. Nuk ka pasur raste që nuk janë zbatuar afatet kohore për dorëzimin e deklaratës së pasurisë.

Gjatë vitit 2019 kanë bërë deklarimin e pasurisë për herë të parë 57 subjekte, nga të cilat 44 deputetë dhe 13 nëpunës civilë. Kanë bërë deklarimin e pasurisë pas largimit nga funksioni 77 subjekte, nga të cilat 62 deputetë dhe 14 nëpunës civilë. Gjithsej nga Kuvendi në vitin 2019 janë 173 subjekte deklaruese periodike-vjetore, nga të cilat 112 deputetë dhe 61 nëpunës civilë.

Vizita studimore dhe trajnime të administratës

Gjatë periudhës raportuese kapacitetet administrative të Kuvendit janë forcuar më tej përmes trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integritetit evropian.

Gjatë periudhës raportuese nëpunës civilë të Kuvendit kanë marrë pjesë në aktivitete trajnimi (vizita studimore, konferenca, *workshop*-e etj.) të organizuara jashtë vendit, si më poshtë:

- Nëpunës civilë të Kuvendit morën pjesë në 24 vizita studimore, që u zhvilluan në parlamentin e Kroacisë, të Norvegjisë, në Parlamentin Europian (Bruksel), në Bundestagun gjerman, në parlamentin austriak (Vjenë), në parlamentin zviceran, në Kosovë dhe në Malin e Zi.

- 30 nëpunës civilë të Kuvendit morën pjesë në trajtime me tematikë të dedikuar në fushën legjislative, me tematikë kërkimin parlamentar, mekanizmat e monitorimit në vendet e Bashkimit Europian, shoqërinë e informacionit, medie etj.

Bazuar në vendimin nr. 61, datë 5.04.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë”, neni 12, si dhe në zbatim të rekomandimeve të GRECO-s, në datën 25.03.2019 dhe 21.05.2019, nga Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi i Deputetëve janë organizuar takime orientuese dhe këshilluese për deputetët që kanë marrë mandatin në periudhën mars–prill–maj 2019.

- Shërbimet e Kuvendit i orientuan deputetët e rinj për veprimtaritë e shërbimeve të tyre në funksion të ushtrimit të detyrës së deputetit. Takimi u zhvillua në Kryesinë e Kuvendit me pjesëmarrjen e dy zëvendëskryetarëve të Kuvendit: znj. Vasilika Hysi dhe z. Myslim Murrizi, të cilët treguar eksperiencat e tyre si deputetë në disa legjislatura.

- Gjithashtu në bashkëpunim me ILDKPKI-në në datat 9.05.2019 dhe 14.06.2019 janë zhvilluar trajnime dhe këshillime për deputetët për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit për çështje të tilla si: forma, mënyra dhe objekti i kontakteve të lejueshme me



grupet e interesit dhe lobistët, zbulimi i konfliktit të interesit, etikës dhe parandalimit të korrupsionit, konflikti i interesit rast pas rasti.

- Në zbatim të vendimit nr. 61, datë 5.04.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë”, vendimit nr. 19, datë 27.09.2018 “Për miratimin e Udhëzuesit të Detajuar të Kodit të Sjelljes”, për vitin 2019 janë bërë katër vetëdeklarime të gjendjes së konfliktit të interesit nga ana e deputetëve, të cilat janë publikuar në faqen e internetit të Kuvendit.



Kapitulli 18

OBJEKTIVAT E SHËRBIMEVE TË KUVENDIT PËR VITIN 2020

Shërbimi Juridik

- Zbatimi i përgjegjësi dhe kompetencave të tij, në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe profesionale.
- Realizimi i përgjegjësi dhe kompetencave të tij në përputhje me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe rregullat ligjore, me qëllim përfundimin e procedurave parlamentare për miratimin e akteve (ligje, vendime, rezoluta) për seancat plenare dhe zbardhjen e akteve për t'u finalizuar me firmosjen nga Kryetari i Kuvendit si dhe dhënien e asistencës në cilësinë e stafit mbështetës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për komisionet hetimore, komisionet e posaçme dhe grupet e punës.
- Dhënia e kontributit për funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së komisioneve, këshillave parlamentare dhe organeve të tjera të Kuvendit, me qëllim ngritjen e cilësisë së punës dhe profesionalizmit të komisioneve të përhershme parlamentare në shqyrtimin e projektligjeve, projektvendimeve, zhvillimit të seancave dëgjimore dhe akteve të tjera normative, duke dhënë asistencën e nevojshme juridike.
- Dhënia e kontributit në përmirësimin e legjislacionit në përputhje me standardet e BE-së.
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të tij.

Shërbimi i Komisioneve

- Organizimi në mënyrë sa më profesionale, etike dhe të paanshme i aktivitetit të komisioneve të përhershëm parlamentar, nëpërmjet koordinimit të punës si me ministritë, institucionet e linjës dhe aktorë të shoqërisë civile, ashtu dhe me strukturat e brendshme parlamentare.
- Rritja e bashkëpunimit me Shërbimin e Seancave Plenare dhe Shërbimin Juridik si dhe fuqizimi i bashkëpunimit në mënyrë permanente me Shërbimin e Kërkimit Parlamentar, me qëllim përgatitjen e një materiali sa më cilësor dhe gjithëpërfshirës për t'u dhënë mundësi anëtarëve të komisionit që të kenë një panoramë më të gjerë mbi një projektligj të caktuar objekt diskutimi nga ndryshimet që ai ka pësuar në kohë e deri te krahasimi i legjislacionit me vendet fqinje.
- Rritja e vazhdueshme e transparencës së veprimtarisë së komisioneve, ku rëndësi të veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me shoqërinë civile, grupet e interesit, duke realizuar përfshirjen e opinioneve, rekomandimeve e sugjerimeve të tyre në procesin vendimmarrës të komisionit.
- Vazhdimi i ushtrimit të kontrollit parlamentar sipas praktikës së re të ndjekur nga komisionet, duke i vizituar institucionet e varësisë në ambientet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e përditshme.
- Forcimi i marrëdhënieve me komisionet homologe, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe marrjen e praktikave më të mira për çështje që përkojnë në fushën e përgjegjësisë së komisioneve, si dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.



- Nxitja e interesit për akses në veprimtaritë parlamentare, si një domosdoshmëri që u mundëson qytetarëve të informohen, të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë veprimtarinë dhe punën e institucioneve, duke u siguruar një mënyrë për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes.

Shërbimi i Seancës Plenare

- Shërbimi i Seancës Plenare do të fokusohet kryesisht në zgjidhjen e të gjitha problematikave të evidentuara në analizën vjetore të tij, me qëllim përmbushjen e detyrave në kohë dhe me cilësi. Përmbushja e rekomandimeve për zgjidhjen e problematikave do të përmirësojë ndjeshëm mbarëvajtjen e punëve në këtë Shërbim, do të ndikojë në përmirësimin e veprimtarisë së organeve drejtuese të Kuvendit dhe të punës në seancë plenare.

- Shërbimi i Seancës Plenare do të rrisë gjithashtu standardin e ekspertizës për çështjet procedurale dhe ligjore për Kryetarin e Kuvendit, organet drejtuese të Kuvendit dhe seancën plenare si dhe ofrimin e një shërbimi me standard më të lartë për anëtarët e Kuvendit.

- Shërbimi i Seancës Plenare do të fokusohet edhe në përmirësimin e aftësive profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme si dhe në njohjen e thelluar të Rregullores së Kuvendit.

- Rëndësi të veçantë Shërbimi i Seancës Plenare do t'u kushtojë çështjeve që janë në vëmendje të projektit PACEP, duke dhënë kontributin e tij për përmirësimin e punës përfaqësuese, ligjvënëse dhe mbikëqyrëse të Kuvendit. Gjithashtu rëndësi të veçantë do t'i kushtojë zbatimit të të gjitha masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Kuvendit (pjesa e SHSP-së) në zbatim të rekomandimeve të raportit të Komisionit European për Shqipërinë.

- Shërbimi i Seancës Plenare do të fokusohet edhe në përmirësimin e bashkëveprimit me shërbimet e tjera, pjesë e Shërbimit Legjislativ, për respektimin e afateve të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar për Integrimin European

- Të ofrojë për Këshillin Kombëtar të Integrimit European (KKIE) asistencë teknike dhe administrative në mbështetje të përmbushjes së misionit të tij si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin european, e cila nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile; mbikëqyr ecurinë e zbatimit të detyrimeve të procesit të integrimit, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për këtë proces.

- Të ofrojë ekspertizë teknike të një standardi të lartë për KKIE lidhur me çështjet apo detyrimet e procesit të integrimit european të Shqipërisë të marra në shqyrtim nga ky Këshill.

Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë

- Vendimi për hapjen e negociatave të Bashkimit European me Shqipërinë në mars të vitit 2020, një vendim dhe mesazh shumë i rëndësishëm për vendin tonë, por dhe për rajonin e Ballkanit, do të shoqërohet me intensifikimin e punës në nivel parlamentar për avancimin me axhendën europiane dhe përputhje edhe me planin e veprimit që do të hartohet nga Kuvendi.

- Intensifikimi i kontakteve me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së për të përfituar nga eksperiencia e tyre në fazën që pason hapjen e negociatave.

- Nxitja e mëtejshme e diplomacisë parlamentare përmes rritjes dhe forcimit të kontakteve me parlamentet e vendeve të ndryshme.

- Fuqizimi i bashkëpunimit me parlamentet e vendeve të rajonit.



Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës

• Vënia në dispozicion të Bibliotekës për të shërbyer si burim informimi për deputetët, komisionet parlamentare dhe stafin mbështetës në përmbushjen e detyrave legjislative.

• Përmirësimi i cilësisë së përmbajtjes së produkteve kërkimore si dhe standardizimi i tyre në nivele bashkëkohor.

• Përdorimi i informacioneve të përditësuara e të besueshme.

• Të memorizohen dhe të ruhen produktet kërkimore të Shërbimit të Kërkimit Parlamentar.

• Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës.

Shërbimi i Financës

• Të rritet niveli i bashkëpunimit me ekipet e programeve buxhetore, me qëllim sigurimin e një planifikimi buxhetor të mirargumentuar dhe në funksion të realizimit me sukses të objektivave në institucion.

• Të sigurojë zbatim me ekonomi dhe efektivitet të buxhetit dhe ta monitorojë atë në mënyrë të vazhdueshme i tij.

• Të sigurojë regjistrime kontabël në formë informatike në kohë sa më të shpejtë dhe duke siguruar besueshmëri të lartë.

• Të sigurojë që në institucion të realizohet inventarizimi fizik i aseteve dhe detyrimeve, me qëllim rritjen e nivelit të saktësisë në pasqyrat financiare.

• Të sigurohet administrimi me ekonomi dhe efektivitet i vlerave materiale dhe monetare të vëna në dispozicion për zhvillimin normal të aktivitetit të Kuvendit bazuar në rregullat dhe standardet buxhetore si dhe gjithë kuadrin ligjor mbi menaxhimin e dhe kontrollin.

• Të rritet niveli i bashkëpunimit me drejtuesit e shërbimeve në institucion për të siguruar një vlerësim sa më real të riskut dhe rishikimin e strategjisë për menaxhimin e tij.

• Të sigurojë rritjen e nivelit profesional të punonjësve nëpërmjet trajnimeve dhe përfshirjes në vendimmarrje.

Shërbimi i Transportit

• Mbajtja në gatishmëri dhe rritja e koeficientit të shfrytëzimit të autoveturave nëpërmjet hartimit dhe ndjekjes së grafikut të shërbimeve e të riparimeve.

• Plotësimi i nevojave për shërbim transporti për delegacionet parlamentare të huaja që vijnë me ftesë të Kuvendit dhe për aktivitete ndërkombëtare parlamentare.

• Hartimi i planit vjetor të shpenzimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Administrative (përgatitja e dokumentit përfundimtar të buxhetit për shpenzime dhe investime).

• Ndjekja e detyrimeve ligjore ndaj Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor dhe Policisë Rrugore për autoveturat e institucionit.

• Të mbështesë menaxherët me informacion teknik të saktë dhe në kohë, në mënyrë që të sigurojë efektivitet të përdorimit të buxhetit të shtetit si dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.

• Plotësimi i nevojave për shërbim transporti për deputetët apo grupe deputetësh që lëvizin jashtë vendit për të marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare.

• Të rishikojë dhe rivlerësojë nivelin e riskut në Shërbimin e Transportit, duke synuar shmangien e rreziqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.



Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve

- Të identifikojë nevojat për organizimin dhe përmirësimin e strukturës organizative të administratës së Kuvendit.
- Të menaxhojë me korrektesë dhe sipas kërkesave të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” Shërbimin Civil të Kuvendit, në mënyrë të veçantë rekrutimin e nëpunësve në administratën e Kuvendit, vlerësimin 6-mujor të punës së nëpunësve civilë dhe këshillimin për nisjen dhe përfundimin e procedurave disiplinore.
- Të planifikojë dhe organizojë në konsultim me eprorët e drejtpërdrejtë të nëpunësve civilë të administratës së Kuvendit dhe me Sekretarin e Përgjithshëm veprimtaritë trajnuese.
- Të drejtojë dhe orientojë sektorin e Trajtimit të Deputetëve për zbatimin e ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 114, datë 24.12.2014 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”.
- Të rishikojë dhe rivlerësojë nivelin e riskut në Shërbim, duke synuar shmangien e rreziqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

Shërbimi i Prokurimit

- Të hartojë regjistrin e prokurimeve sipas buxhetit të vitit të miratuar nga Ministria e Financave dhe pasi ta miratojë tek titullari i autoritetit kontraktor ta dërgojë në APP dhe në Thesarin e Shtetit.
- Të hartojë dhe ndjek procedurat e prokurimit për punë, shërbime dhe mallra deri në përfundimin e lidhjes së kontratave.
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e ligjshmërisë të procedurave të prokurimit bazuar në udhëzimet dhe VKM-në në fuqi, të vlerësojë riskun e çdo procedure dhe të raportojë pranë strukturave përkatëse sipas afateve.
- Të evidentojë problematikat dhe të hartojë aktet nënligjore për funksionimin sa më të plotë dhe korrekt të procedurave të prokurimit.
- Të forcojë bashkëpunimin me drejtuesit e shërbimeve në institucion për të siguruar një vlerësim sa më real të riskut dhe rishikimin e strategjisë për menaxhimin e tij.

Shërbimi i Mirëmbajtjes

- Garantimi i infrastrukturës të sistemet dhe shërbimet në qëndrueshmëri teknike dhe performancës teknologjike, duke u paraprirë dhe përgjigjur kërkesave administrative.
- Paraqitja e gjithë dokumentacionit shkresor urdhërues për të gjitha procedurat e menaxhimit të fondeve financiare në dispozicion për prokurimin e materialeve të mirëmbajtjeje, të vlerave materiale në kohë sipas kërkesave të aprovuara.
- Ndjekja dhe angazhimi e të gjitha burimeve të brendshme për plotësimin e kërkesave për shërbime, mbajtja në gatishmëri pune e pajisjeve të nevojshme, mbajtja në standarde të mjediseve dhe zyrave të Kuvendit për t’i bërë ato sa më funksionale për veprimtarinë parlamentare.
- Të kryejë çdo detyrë tjetër që ka të bëjë me mirëmbajtjen dhe pastërtinë e godinave në administrim të Kuvendit.
- Të menaxhojë materiale dhe shërbime të ndryshme për përmasimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nivelit të riskut në Shërbimin e Mirëmbajtjes për të shmangur ose ulur rrezikun dhe për ta përmirësuar këtë Shërbim.



Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit

- Përdorim më eficient i teknologjisë së informacionit në përmirësimin e funksioneve të Kuvendit.
- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT).
- Analiza e strukturës së dokumenteve parlamentare nga pikëpamja IT në funksion të përmirësimit të transparencës dhe qëndrueshmërisë.
- Krijimi i ciklit të punës (*workflow*) të dokumenteve të procesit ligjvënës.
- Analizimi dhe përcaktimi i metadave dhe gjetja e rregullsisë e strukturës së dokumentit.
- Vënia në zbatim i Editorit XML.
- Digjitalizimi i arkivit të dokumenteve parlamentare.
- Krijimi i repository (magazinë dokumentesh):
 - a) zhvillimi i *library management sistem*;
 - b) zhvillimi i *research management system*.

Shërbimi i Botimeve Parlamentare

- Sektori i Redaktorëve gjatë vitit 2020 do të kryejë me përpikëri dhe cilësi zbardhjen dhe redaktimin e seancave plenare, të mbledhjeve të komisioneve parlamentare, Byrosë së Kuvendit, Konferencës së Kryetarëve, Komisionit për Reformën Zgjedhore, Grupit të Deputetëve “Miq të Fëmijëve” si dhe redaktime të tjera për nevojat e Kuvendit.
- Shërbimi i Botimit Parlamentar gjatë vitit 2020 do të ofrojë:
 - zbardhjen në kohë të seancave plenare;
 - korrektimin dhe redaktimin në dy nivele të seancave plenare;
 - faqosjen dhe paraqitjen e procesverbaleve për deputetët dhe për botim;
 - zbardhjen në kohë të mbledhjeve të komisioneve të përhershme dhe atyre të veçanta të Kuvendit për çdo vit;
 - zbardhjen, korrektimin, redaktimin dhe paraqitjen në kohë të procesverbaleve të mbledhjeve të Byrosë Parlamentare, të komisioneve të veçanta, të komisioneve *ad hoc* etj.
- Sektori i Botimeve Parlamentare për vitin 2020 do të realizojë:
 - publikimin e seancave plenare në kolanën “Punime të Kuvendit” si dhe publikimin e veprimtarisë së shumanshme të Kuvendit në revistën periodike “Kuvendi”;
 - përgatitjen e botimeve në bashkëpunim me Shërbimin e Kërkimit Shkencor dhe Bibliotekën, që pasqyrojnë historinë dhe veprimtarinë e Kuvendit.
 - përgatitjen për shtypshkrim të fjalimeve, manualeve, studimeve, monografive etj.

Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun

- Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit qytetar mbi veprimtarinë e Kuvendit.
- Informimi sa më i plotë dhe edukativ mbi punën dhe veprimtarinë e Kuvendit, me qëllim përmirësimin e imazhit të Kuvendit tek opinioni publik.
- Dhënia e informacionit dhe dokumentacionit publik në kohë reale dhe ruajtja e informacioneve sensitive.
- Rritje e bashkëpunimit për të nxitur dhe siguruar që teknologjia e informacionit të përdoret sa më gjerë për informimin e publikut, studentëve dhe qytetarëve.
- Bashkëpunimi sa më i mirë dhe koordinimi i marrëdhënieve me median për pasqyrimin real të veprimtarisë së Kuvendit.



- Kanali “RTSH-Kuvend” të jetë 24 orë në transmetim mbi aktivitetin parlamentar.
- Rritje e vizibilitetit të punës së Kuvendit si dhe qasje më proaktive ndaj qytetarëve nëpërmjet medias sociale.



